www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 153

Tiranë – E hënë, 2 shtator 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 320, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18799
Dekret i Presidentit nr. 321, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18799
Dekret i Presidentit nr. 322, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.	18799
Dekret i Presidentit nr. 323, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18799
Dekret i Presidentit nr. 324, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18800
Dekret i Presidentit nr. 325, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18800
Dekret i Presidentit nr. 326, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18800
Dekret i Presidentit nr. 327, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18801
Dekret i Presidentit nr. 328, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18801
Dekret i Presidentit nr. 329, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18801
Dekret i Presidentit nr. 330, datë 27.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18802

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 28.8.2024	Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2024–2028	18802
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 646, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Francës	18859
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 647, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	18860
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 648, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës	18862
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 649, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë	18865
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 650, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Letonisë	18867
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 651, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	18870
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 652, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës	18873
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 654, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	18875
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 655, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës	18876
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 656, datë 23.8.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë	18876
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6827/1, datë 27.8.2024	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare	18877

Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 27, datë 27.8.2024 — Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 18878

Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 28, datë 27.8.2024 — Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 18879

DEKRET
Nr. 320, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Sofia Vasil Shaka (Mingo)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 321, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Kristo (Christos) (Kristaq) Jorgji Xhima (Tzimas)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 322, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Drin Ismail Kokaj
2. Njomza Arben Kusari
3. Florent Vesel Bujupi
4. Eren Faruk Saat

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 323, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kujtesa Memet Susuri
2. Nasuf Maliq Gërmizaj
3. Rrahim Gjafer Kadriaj
4. Veton Ruzhdi Omaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 324, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dardan Shkelzen Gjevori
2. Shqipe Ebib Krasniqi (Islamaj)
3. Hasan Mustafë Loxha
4. Shemsije Pelivan Badalli (Hoxhaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 325, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mustafa Nezih Ismail Kubaç
2. Enes Halim Karik
3. Avni Ibrahim Ymeri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 326, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Kayhan Ali Kaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 327, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Jeta Xhevdet Loxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 328, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Teuta Bajram Januzi (Osmani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 329, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Semra Adem Lamçe-Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 330, datë 27.8.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fidan Arsim Misini
2. Valdrin Bekim Mjeku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 544, datë 28.8.2024

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE 2024–2028

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2024–2028, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DOKUMENTI I POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE
2024–2028
2024

PËRMBAJTJA E LËNDËS

SHKURTIMET
FALËNDERIME
I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI DOKUMENTIN E POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE
i. Vizioni
ii. Koncepti i përfshirjes sociale dhe nevoja për një analizë rigoroze
iii. Kuadri
iv. Dokumenti i politikave dhe përparësitë e tij
v. Strukturat për zbatimin e dokumentit
vi. Arritja e rezultateve
1. SITUATA AKTUALE
1.1 Strukturat e koordinimit për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri
2. VIZIONI, POLITIKAT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE
- OBJEKTIVAT DHE REZULTATET
2.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM
2.2 INSTRUMENTET
2.2.1 NDRYSHIME NË MENAXHIMIN E PROCESIT DHE NË KULTURËN ANALITIKE DREJT PËRFSHIRJES SOCIALE
2.3 OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE ARRITJET KRYESORE
2.3.1 Shtylla A: Sisteme të qëndrueshme për përfshirjen sociale
2.3.2 Shtylla B: Sisteme efektive për menaxhimin e përfshirjes sociale
2.3.3 Shtylla C: Përmirësimi i dialogut mbi politikat
2.4 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË
2.5 MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT PËR DOKUMENTIN E POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE
4. BURIMET FINANCIARE DHE ALOKIMI I BUXHETIT (në 000 lek)

5. MATJA DHE MONITORIMI I PËRFSHIRJES SOCIALE DHE VARFËRISË NË SHQIPËRI
5.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM
5.2 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT E VARFËRISË
5.3 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE PËR PUNË
5.4 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT E SHËNDETIT
5.5 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN
5.6 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT E MOSPLOTËSIMIT TË NEVOJAVE BAZË (DEPRIVIMI MATERIAL)
5.7 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI TREGUESIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT
6. SHTOJCA 1: MONITORIMI I PËRFSHIRJES SOCIALE
a) Varfëria dhe mbrojtja sociale
b) Punësimi dhe aftësitë
c) Shëndeti
d) Arsimi dhe formimi
e) Nevojat bazë
f) Të drejtat e njeriut
7. REFERENCA

Shkurtimet

AANJ	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
AeFP	Anketa e Forcave të Punës
AFTP	Arsimi dhe Formimi Teknik dhe Profesional
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AMNJ	Anketa për Matjen e Nivelit të Jetesës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AROPE	Në rrezik varfërie dhe përjashtimi social
ESSPROS	Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPS	Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
FSDKSh	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
GNSPS	Grupi Ndërinstitucional i Statistikave të Përfshirjes Sociale
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MAD	Ministri, Agjenci dhe Departamente
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MHK	Metoda e Hapur e Koordinimit
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PISA	Programi për Vlerësimin e Integruar të Nxënësve
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
SBT	Struktura Burimore Teknike
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
SKMS	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

FALËNDERIME

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioneve partnere kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktorëve të shoqërisë civile aktivë në fusha që janë thelbësore për përfshirjen sociale.

Dokumenti ka një rëndësi të madhe sepse hap rrugën për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale dhe qëndrueshmërisë sociale-ekonomike në nivel kombëtar. Ai përbën një nga parakushtet për të garantuar që qeveria të mund të përcaktojë nivelin e qasjes së qytetarëve në të mirat dhe shërbimet publike dhe krijimin e kohezionit social të qëndrueshëm, çka përbën një detyrim i cili rrjedh nga procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Për përfundimin me sukses të këtij procesi, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendin, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dëshiron të falënderojë Zyrën e Kryeministrit, Institutin e Statistikave, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Brendshme, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimin Social Shtetëror, Institutin e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, si dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Një falënderim i veçantë shkon për partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht PNUD-in, për ndihmesën e tyre në përgatitjen dhe përfundimin e këtij dokumenti të rëndësishëm mbi politikat e përfshirjes sociale në Shqipëri.

Ne shprehim angazhimin tonë për të vazhduar bashkëpunimin e mëtejshëm me ministritë, institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtare për zbatimin dhe monitorimin efektiv të masave dhe aktiviteteve të parashikuara me synim realizimin e objektivave të Dokumentit të Përfshirjes Sociale.

Albana Koçiu
MINISTRE E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI DOKUMENTIN E POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE

I. Vizioni

Vizioni i Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) është: të garantojë një sistem transparent, të përgjegjshëm, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për vlerësimin e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të varfërisë dhe mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive, shëndetit, arsimit, strehimit dhe mungesës së nevojave bazë, si dhe të të drejtave të njeriut, dhe krijimin e kohezionit social të qëndrueshëm.

Objektivi i përgjithshëm i DPPS-së është të krijojë një kuadër të balancuar dhe të vazhdueshëm për të siguruar matjen, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes sociale në Shqipëri përmes një grupi treguesish të konsoliduar, duke përmirësuar kështu rrugët e lidhjes së përfshirjes sociale me përmirësimin e politikave të qeverisë dhe përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE.

Krahas ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë ekonomike, ndikimi i masave për uljen e varfërisë dhe nxitjen e përfshirjes sociale është një nga përparësitë kyçe të qeverisë, sepse këto masa do të ndihmojnë në çlirimin e potencialit të konsiderueshëm njerëzor të pashfrytëzuar në Shqipëri, si dhe uljen e ndikimit pengues të pabarazisë mbi rritjen ekonomike.

Për të siguruar një program efikas të përfshirjes sociale, qeveria do të forcojë kuadrin e përgjithshëm monitorues, do të krijojë Mekanizma për garantimin e një analize të saktë dhe do të përfshijë treguesit e BE-së dhe OKB-së për të matur përfshirjen sociale, përkrah një grupi plotësues të treguesve në nivel kombëtar.

II. Koncepti i përfshirjes sociale dhe nevoja për një analizë rigoroze

Nevoja për analizë rigoroze rrjedh nga fakti se termat varfëri, pabarazi dhe përjashtim social përdoren shpesh për t'iu referuar të njëjtës dukuri. Megjithatë, ndërsa varfëria dhe pabarazia janë rrjedhoja, përjashtimi social është edhe rrjedhojë, edhe proces. Përjashtimi mund të kryqëzohet me varfërinë që shkaktohet nga një grup disavantazhesh të shumëfishta dhe të ndërlidhura, të cilat çojnë si në varfëri ekonomike, ashtu edhe në përjashtim social.

Gjithashtu, përjashtimi është një element kyç për të shpjeguar se pse disa grupe mbeten në kurthin e varfërisë dhe nuk arrijnë të përfitojnë plotësisht nga

investimet publike, si për shembull, në arsim dhe shëndetësi. Individëve të përjashtuar nga shoqëria shpesh u mohohen mundësitë në dispozicion për të rritur të ardhurat e tyre dhe për të shpëtuar nga varfëria.

Identifikimi dhe adresimi i nevojave specifike përmes monitorimit të përfshirjes sociale bën të mundur zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse, efikase dhe shumëplanëshe që kanë në fokus gjininë, moshën, përkatësinë etnike, vendbanimin, aftësinë e kufizuar apo orientimin seksual.

Koncepti i përfshirjes sociale nënkupton ngritjen e pyetjes se pse grupe të caktuara janë më tepër të përfaqësuar ndër të varfrit; pse grupe të caktuara mbeten në kurthin e varfërisë duke mos mundur të përfitojnë plotësisht nga investimet publike, si për shembull, në arsim, shëndetësi, strehim social etj. dhe cilat janë sfidat për shërbime me cilësi më të ulët për grupe të caktuara.

Pjesëmarrja e barabartë në shoqëri për të gjithë (gra, burra, vajza, të rinj, të moshuar etj.), duke përfshirë individët në rrezik përjashtimi, zgjeron mundësinë që një shoqëri të arrijë potencialin e saj të plotë, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në nivelin e qeverisjes. Adresimi i pabarazive dhe përfshirja sociale duhet të realizohen jo vetëm për të pasur një ndikim pozitiv te grupe të përjashtuara, por gjithashtu, ndikim pozitiv në ekonomi dhe në qeverisje më të mirë.

Koncepti i përfshirjes sociale nxjerr në pah natyrën e ndërthurur dhe shumëdimensionale të varfërisë, pabarazisë sociale dhe diferencave gjinore si për shembull diskriminimi, aksesin në edukim, shëndetësi, pjesëmarrjes në tregun e punës. Barazia gjinore dhe përfshirja sociale vlerësohen jo vetëm si një aspekt themelor i të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale, por edhe një parakusht për të përmirësuar procesin e zhvillimit duke sjellë çështjet sociale në planin e parë të ndërhyrjeve në fusha të ndryshme.

Gjithashtu, përjashtimi social nxjerr në pah edhe normat dhe sistemet e besimit që qëndrojnë në themel të përjashtimit. Në përgjithësi, shkaqet themelore të varfërisë janë të padukshme në të dhënat empirike standarde dhe për rrjedhojë, mbeten të paeksploruara në analizat e zakonshme të varfërisë, si dhe nuk përfshihen në strategjitë për uljen e varfërisë. Përjashtimi social prek individë dhe grupe në disa aspekte njëherazi i shoqëruar me dallimet për shkak të gjinisë, paaftësisë, moshës, përkatësisë etnike dhe/ose vendbanimit.

Si rrjedhojë, politikat e përfshirjes sociale duhet të adresojnë njëherazi këto dimensione. Individët dhe grupet marrin pjesë në shoqëri në tri fusha të ndërlidhura të përfshirjes sociale: tregjet, hapësirat dhe shërbimet. Këto fusha përmbajnë pengesa, por njëkohësisht edhe mundësi për përfshirje sociale. Eliminimi i pengesave dhe qasja në shërbime është thelbësore për të përmirësuar kushtet për të garantuar pjesëmarrjen në jetën sociale-ekonomike.

III. Kuadri

Kuadri i përgjithshëm i përfshirjes sociale i parashtruar në këtë dokument të politikave, që bazohet në tregues nga gjashtë fusha, do të garantohet me anë të masave që ofrojnë qartësi dhe qëndrueshmëri lidhur me hapat që duhen ndërmarrë. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm se vetëm ky kuadër treguesish në vetvete nuk do të jetë i mjaftueshëm për të garantuar monitorim rigoroz dhe të rregullt të përfshirjes sociale. Për të garantuar këtë monitorim do të nevojitet gjithashtu angazhim politik, si dhe përgjegjësi dhe përgjegjshmëri nga e gjithë administrata publike.

Përmirësimi i treguesve në vazhdimësi përmes rishikimit periodik të kuadrit dhe analizës së kontekstit të politikave në dinamikën e tyre sociale, si dhe përmes krijimit të kapaciteteve teknike dhe administrative do të rrisë efikasitetin në mbledhjen e të dhënave. Me këtë synohet gjithashtu përmirësimi i njohurive analitike dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë që ka përfshirja sociale për kohezionin social, rritjen ekonomike dhe zhvillimin politik të Shqipërisë në kontekstin e procesit të anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian (BE).

Përparësi do t'u jepet projekteve dhe programeve që e vënë theksin te lidhjet ndërmjet përfshirjes sociale, uljes së varfërisë, punësimit, shëndetit, arsimit, nevojave bazë dhe të drejtave të njeriut. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të matjes së përfshirjes sociale do të rrisë kapacitetet e administratës për vlerësimin e politikave dhe kryerjen e analizave më të thella në këtë sektor. Do të zhvillohen diskutime me një numër grupesh të interesuara, mbi mënyrat e pasurimit të analizave vjetore të përjashtimit social, si dhe mbi mënyrën e rritjes së llogaridhënies së zyrtarëve për politikat dhe programet për të cilat janë përgjegjës.

IV. dokumenti i politikave dhe përparësitë e tij

Gjatë zbatimit të planit, standardet e të dhënave do të rishikohen dhe përditësohen nga Grupi Ndërinstitucional i Statistikave të Përfshirjes Sociale[1] (GNSPS), me ambicien për të garantuar që treguesit e përfshirjes sociale të Shqipërisë të kenë përkufizime të qarta dhe ndjeshmëri gjinore në adresimin e nevojave specifike për gjithë grupet, plotësisht në përputhje me standardet e BE-së, Parimet e Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale,[2] këta tregues duhet të integrohen në mënyrë progresive me sistemet statistikore të mbrojtjes sociale (ESSPROS) të BE-së.

Sistemet e përfshirjes sociale në institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore do të forcohen për të garantuar mbledhjen e të dhënave për përfshirjen sociale sipas gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe variablave të tjerë kyçë. Të dhënat për këta variabla ndërsektorialë duhet të jenë plotësisht të harmonizuara, për monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së mbulimit dhe aksesit në shërbimet publike në nivel kombëtar.

Përfshirja sociale kërkon sisteme mbështetjeje moderne dhe të mirë-integruara, që trajtojnë dhe adresojnë nevojat specifike që kanë grupet e veçanta. Për rrjedhojë, do të vihen në shërbim burime për të rishikuar strukturat institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e sistemeve efikase për monitorim dhe vlerësim të përfshirjes sociale. Vlerësimi i nevojave për Mekanizmat institucionalë do të jetë një përparësi për rekomandimet e Raporteve Vjetore të Dokumentit të Përfshirjes Sociale në Shqipëri. Të dhënat do të integrohen nga anketat, ku përfshihet AANJ (Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës), si dhe të dhënat e përftuara nga ESSPROS (Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale), i cili është një Mekanizëm i rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e shpenzimeve dhe përfitimeve sociale për familjet dhe individët në vështirësi.

Është domosdoshmëri ngritja e një sistemi të unifikuar të shkëmbimit të informacionit, komunikimit dhe konsultimit për hartimin e një modeli konceptual të monitorimit të përfshirjes sociale, si dhe për bashkërendimin dhe financimin e veprimtarive të ndryshme. Për këtë qëllim, qeveria do të kërkojë mbështetje financiare dhe asistencë teknike nga partnerët e saj.

Trajnimet sistematike do të zhvillojnë aftësitë e punonjësve të administratës në nivel qendror dhe vendor. Ngritja e kapaciteteve, përveç modernizimit të kulturës së menaxhimit, ndikon gjithashtu në zhvillimin e Mekanizmave që do të garantojnë përfshirje sociale në shoqëri dhe do të jenë një komponent i politikave publike dhe programeve, që synojnë rritjen e kapaciteteve për përfshirjen sociale.

Strategjitë dhe planet kombëtare, legjislacioni, rregulloret dhe anketat nuk janë të mjaftueshme për arritjen e vizionit tonë për një sistem të profesionalizuar për gjurmimin e përfshirjes sociale, si dhe për të qenë në hap me zhvillimin e treguesve të BE-së në fushat kryesore të politikave publike. Krahas përkushtimit politik, zhvillimi i funksioneve të ndryshme të përfshirjes sociale në institucionet kyçe, si dhe në ministritë e linjës dhe njësitë shpenzuese, lidhet ngushtë me integritetin, aftësitë dhe përkushtimin e nëpunësve publikë.

V. Strukturat për zbatimin e dokumentit

Qeveria shqiptare ka tolerancë zero ndaj neglizhencës kundrejt përmirësimit të treguesve të përfshirjes sociale. Kudo dhe kurdo që do të zbulohen probleme, dobësi do të merren masa për përgatitjen dhe paraqitjen e ndryshimeve të nevojshme në instrumente, sisteme dhe struktura.

Grupi Ndërinstitucional i Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS), i bashkëkryesuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe INSTAT-i, do të ngrihet dhe do të funksionojë me pjesëmarrjen e zyrtarëve të nivelit të lartë nga ministritë e linjës, INSTAT-i dhe institucionet kryesore qeveritare përgjegjëse për mbrojtjen sociale, punësimin, shëndetin, arsimin, strehimin, aksesin në drejtësi dhe të drejtat e njeriut, si dhe të përfaqësuesve nga qarqet akademike dhe institutet kërkimore.

GNSPS-ja do të japë udhëzime gjithëpërfshirëse për përcaktimin dhe përkufizimin e të dhënave për përfshirjen sociale dhe tregues të ndjeshëm gjinorë, të cilët do të përdoren për të analizuar në mënyrë retrospektive tendencat e përfshirjes sociale duke përdorur burimet ekzistuese të të dhënave

[1] Grupi i Statistikave të Përfshirjes Sociale përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet kryesore qeveritare përgjegjëse për mbrojtjen sociale, punësimin dhe zhvillimin e sipërmarrjes, shëndetin, arsimin, strehimin, drejtësinë dhe të drejtat e njeriut.

[2] https://op.europa.eu/webpub/empl/european-pillar-of-social-rights/en/

administrative dhe Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) dhe lidhjet me Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF), Anketën e Forcave të Punës (AFP) dhe burime të tjera të të dhënave, si dhe zhvillimin e vazhdueshëm të treguesve të BE-së dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

VI. Arritja e rezultateve

Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS) për të rishikuar treguesit do të garantojë një qëndrueshmëri afatshkurtër dhe afatgjatë të sistemit të treguesve. Struktura Burimore Teknike (SBT) do të kryejë funksionin e bashkërendimit të komponentëve të shtyllave përkatëse dhe do të nxitë zbatimin e nismave dhe reformave në secilin komponent.

Rezultatet e pritshme nga Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale janë:

- Zhvillimi, miratimi dhe përfshirja e politikave të përfshirjes sociale në strategjitë sektoriale dhe kuadrot/strategjitë e politikave kombëtare deri në vitin 2028;

- Harmonizimi/integrimi i raportimit për përfshirjen sociale në raportimin e rregullt të qeverisë, në kuadër të diskutimit të politikave të saj me BE-në për përparimin e bërë në përfshirjen sociale;

- Ulja e varfërisë dhe margjinalizimit përmes shtimit të burimeve dhe bazuar në shtimin e njohurive mbi llojet, shkaqet dhe intensitetin e përfshirjes sociale.

Reformat e tjera të parashikuara në Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale kanë të bëjnë me: Ngritjen e Strukturës Burimore Teknike (SBT) për përfshirjen sociale dhe analizën e varfërisë, çështjet metodologjike për analizimin e të dhënave të AANJ-së dhe analizën dytësore të të dhënave të AANJ-së; anketat cilësore të përjashtimit social në Shqipëri për vlerësimin e intensitetit, shkaqeve dhe llojeve të tij; fjalorin e termave të përfshirjes sociale; shqyrtimin institucional të drejtimit të përfshirjes sociale dhe promovimin e dialogut mbi politikat e përfshirjes sociale në Shqipëri, do të ndahen në faza dhe do të zbatohen gjatë të gjithë periudhës së planit.

Partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë kanë një rol kyç në zhvillimin e sistemit të monitorimit të përfshirjes sociale të vendit, jo vetëm përmes mbështetjes së tyre financiare në investimet e konsiderueshme që nevojiten në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, por edhe përmes përvojës dhe ekspertizës teknike që mund të ofrojnë.

Veprimtaritë apo reformat e planifikuara për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale nuk mund të realizohen të gjitha menjëherë; burimet financiare dhe njerëzore duhet të planifikohen në kohë. Për rrjedhojë, veprimtaritë do të zbatohen të ndara në faza gjatë periudhës së zbatimit të planit.

I. Situata aktuale

Pas dhënies së statusit të vendit kandidat për në BE, në qershor të vitit 2014 dhe vendimit për hapjen e negociatave për anëtarësim në mars të vitit 2020, BE-ja mbajti konferencën e parë ndërqeveritare dhe hapi zyrtarisht negociatat me Shqipërinë në korrik të vitit 2022. Për rrjedhojë, masat drejt përmirësimit të përfshirjes sociale dhe reduktimit të varfërisë bëhen edhe më shumë një komponent i detyrueshëm për politikat e integrimit në BE, kryesisht në kuadër të Kapitulli, 19, "Punësimi dhe Politikat Sociale" dhe ndërthuret me Kapituj të tjerë si kapitulli 23, (Të drejtat themelore) kapitulli 26, (Arsimi dhe kultura) dhe kapitulli 28, (Shëndetësia). Qeveria e Republikës së Shqipërisë është angazhuar në plotësimin e detyrimeve të BE-së siç janë përcaktuar në samitet e Lisbonës dhe të Kopenhagës, në dokumentin e zhvillimit të BE-së - *Drejt një Evrope të Qëndrueshme 2030* - dhe në dokumente të tjera përkatëse. Po ashtu, vendi është i angazhuar në plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), një pjesë e të cilave ndërlidhen drejtpërdrejtë me përfshirjen sociale, si: objektivi nr. 1 (pa varfëri), që kërkon krijimin e kornizave të politikave të shëndosha në favor të të varfërve dhe me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, për të mbështetur investimin e përshpejtuar te masat për zhdukjen e varfërisë, nr. 3 (Shëndet i mirë për të gjithë dhe mirëqenie), nr. 5 (Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave), nr. 6 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike), nr. 10 (Ulje e pabarazisë), nr. 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme, që përfshin edhe fushën "nevojat bazë" dhe nr. 16 (Shoqëri paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse) të OKB-së. DPPS-ja pasqyron lidhjen e drejtpërdrejtë me këto objektiva.

Një nga detyrimet për procesin e integrimit në BE përfshin zhvillimin e një dokumenti, i cili përfaqëson një politikë për rritjen e nivelit të përfshirjes sociale dhe reduktimit të varfërisë në vend, në kuadër të procesit të anëtarësimit. Ky dokument përfaqëson themelet e negociatave me Komisionin Evropian në kapitujt e lidhur me çështjet që marrin në konsideratë treguesit dhe

objektivat e miratuara nga shtetet anëtare të BE-së. Qeveria e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) kanë investuar në përpjekjet për të kryer periodikisht Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), e cila do të përmirësojë cilësinë e të dhënave, do të garantojë harmonizimin e monitorimit të treguesve të përfshirjes sociale me ato të shteteve anëtare të BE-së, dhe do të ofrojë një bazë për hartimin e një dokumenti të përshtatshëm strategjik për rritjen e nivelit të përfshirjes sociale dhe uljen e varfërisë në Shqipëri.

Në përgjithësi, investimi social, i cili forcon aftësitë dhe kapacitetet e njerëzve dhe i mbështet ata për të marrë pjesë plotësisht në tregun e punës dhe në jetën sociale, është kyç për konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike.[3] Fushat kryesore të politikave përfshijnë arsimin gjithëpërfshirës; kujdesin cilësor për fëmijët; kujdesin shëndetësor gjithëpërfshirës; mundësitë e zgjeruara për formim dhe zhvillim të aftësive; ndihmën për të kërkuar punë dhe ndihmën për punësim; rehabilitimin dhe riintegrimin e grupeve të cenueshme, si personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarit nga trafikimi, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje; strehimin social të përballueshëm financiarisht dhe drejtësinë sociale. Politika të tilla duhet të orientohen drejt të gjithë njerëzve dhe në veçanti drejt grupeve të cenueshme, duke rritur aksesin e tyre në shërbime universale cilësore që garantojnë të drejtën për strehim të përballueshëm financiarisht, arsim/formim universal cilësor përgjatë të gjithë jetës, mbështetje për fëmijët, kujdes shëndetësor dhe social, mundësi për përballimin financiar të energjisë, ujit dhe shërbimeve të transportit.

Përfshirja sociale ka të bëjë me masat që u mundësojnë individëve dhe grupeve të kenë qasje në shërbimet publike në mënyrë që të marrin pjesë me shkallën më të lartë të aftësive të tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë në të cilën jetojnë. Për këtë arsye, politikat që mbështesin përfshirjen, pra, kanë për qëllim të sigurojnë qasje për të gjithë qytetarët në shërbime publike cilësore dhe në të mira publike që rrisin mirëqenien e tyre.

Për të vlerësuar intensitetin, shkaqet dhe llojet e përfshirjes sociale, krahas strategjive të veçanta sektoriale, duhet të kuptohet mirë konteksti më i gjerë i zhvillimit, varfërisë dhe ai institucional, si dhe faktorët që ndikojnë në përjashtimin, faktorë me bazë moshën, gjininë, përkatësinë etnike, vendndodhjen, punësimin, të ardhurat, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual. Shihni figurën 1 më poshtë. Në fakt, këto janë shkaqet dhe pasojat e përjashtimit ku mbështetet dokumenti i politikave dhe masat kundër përjashtimit social.

Figura 1. Të kuptohen arsyet kryesore të përfshirjes sociale



Në përgjithësi, investimi social, i cili forcon aftësitë dhe kapacitetet e njerëzve dhe i mbështet ata për të marrë pjesë plotësisht në tregun e punës dhe në jetën sociale, është kyç për konkurrueshmërinë dhe rritjen[4]. Rritja vjetore mesatare e Shqipërisë gjatë periudhës 2017 dhe 2021 ka qenë e paqëndrueshme. Në vitin 2017, ajo ishte 4,24% duke shënuar një rritje nga rritja e zakonshme prej 3% në vitet e mëparshme. Gjatë vitit 2020, u ul në 3,48% për shkak të tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë së COVID-19, për t'u rritur në 8,54% gjatë vitit 2021.[5] Remitancat janë rritur me 12% të PBB-së për periudhën 2020–22,[6] 10,6% në vitin 2014 kundrejt vitit 2013, megjithëse mbeten dukshëm më të ulëta në krahasim me vitin 2012.

Niveli i varfërisë në Shqipëri deri në vitin 2008 ka qenë në rënie, por prej këtij viti e në vijim, kriza

[3] Rregullorja (BE) 2021/1057, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 24 qershor 2021, për krijimin e Fondit Social Evropian Plus (ESF+) dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 1296/2013, në respektim të nenit 174 i Traktatit të Themelimit dhe Funksionimit të Bashkimit i cili i referohet forcimit të kohezionit ekonomik, social dhe territorial.

[4] Komisioni Evropian (2013) Drejt Investimit Social për Zhvillim dhe Kohezion, Bruksel, 20.2.2013, COM (2013) 83 versioni përfundimtar.

[5] Norma e rritjes së PBB-së në Shqipëri 1981–022 | MacroTrends.

[6] Remitancat, BP: Shqipëria, një nga dhjetë vendet përfituese më të mëdha | RTSH RTI.

ekonomike pati një ndikim.[7] Sipas INSTAT-it, niveli i varfërisë u rrit nga 12,4% në vitin 2008 në 14,3% në vitin 2012.[8] Në vitin 2019 shkalla e varfërisë ishte 10%, që tregon një rënie të madhe nga shkalla e varfërisë prej vitit 2016 prej 23,9% [9].

Një rikuperim i fuqishëm u krye në vitin 2021, për shkak të politikave nxitëse dhe rikuperimin post-COVID, ndërtimit dhe aktiviteteve në industrinë nxjerrëse.

PBB-ja reale u rrit në 8,5%, duke u rikuperuar plotësisht nga recesioni i shkaktuar nga pandemia. Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri, në vitin 2021 është 22,0 %, duke pësuar një rritje të lehtë prej 0.2 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020.[10] Shpenzimet publike (si përqindje e PBB-së) arritën në 31.5%, me një rënie të lehtë nga 32.6% në vitin 2020, ndërsa të ardhurat publike (si përqindje e PBB-së) u rritën lehtë në 27.0% krahasuar me 25.9% në vitin 2020.[11] Nga ana tjetër, rritja nuk solli rritje të punësimit krahasuar me nivelin e para pandemisë, ai mbeti 12% edhe në vitin 2021 (për grup-moshën 15–64 vjeç). Të dhënat ekzistuese tregojnë se niveli i papunësisë është më i theksuar te personat me arsimim më të ulët, gratë, banorët në zonat rurale dhe qytete të vogla dhe ndër shtresat e tjera vulnerabël të popullsisë duke ndikuar në një masë edhe më të madhe në nivelin e varfërisë së tyre.[12] Sipas studimit "Harta e përgjegjshme gjinore e lidhjeve ndërmjet përfshirjes sociale dhe vulnerabilitetit" të realizuar nga UN Women në bashkëpunim me INSTAT-in vajzat dhe gratë shfaqin një rrezik më të lartë të përjashtimit social ose rrezikut për të rënë në varfëri krahasuar me djemtë dhe burrat. Ky rrezik ka një trend të ngjashëm për vitin 2017 dhe 2018, për të gjithë treguesit përcaktues të rrezikut të varfërisë. (Në 2017 femra 23,9% dhe meshkuj 23,5% në rrezik të varfërisë; në 2018 femra 23,8% dhe meshkujt 23% në rrezik të varfërisë; në vitin 2019 femra 23% dhe meshkuj 22,2% në rrezik të varfërisë). Në vitin 2020, rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social ka qenë 43.4%. Vajzat dhe gratë paraqesin rrezikun më të lartë për të qenë të varfra. (INSTAT 2022. Burra dhe gra.)

Deprivimi material përfshin aspektet e mëposhtme në Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale: strehimin, zotërimin e mallrave afatgjata dhe plotësimin e nevojave bazë si ushqimi, veshja dhe higjiena. INSTAT-i ka realizuar anketën e të ardhurave dhe kushteve të jetesës sipas EU-SILC, 2021, dhe të dhënat tregojnë se deprivimi material, pra përqindja e popullsisë me mungesë të të paktën 4 nga 9 artikujt e deprivimit material, vlerësohet në 35,2% në vitin 2021 kundrejt 34,7% në vitin 2020, duke u rritur me 0,5 pikë përqindjeje (INSTAT-i, të ardhurat dhe kushtet e jetesës në Shqipëri, 2021). Ndërsa mesatarja në BE e familjeve në rrezik të shkallës së varfërisë është në nivelin 16.8%, në Shqipëri ky tregues është në nivelin 22%, pra 3.2% më i lartë. Treguesi i individëve në rrezikun e varfërisë ose përjashtimit social vlerësohet në 43,9% në vitin 2021 krahasuar me 43,4 % në vitin 2020. (INSTAT, 2021).

Konsumi Individual Aktual (KIA), si një matës i mirëqenies materiale të familjeve, në vitin 2019 Shqipëria shënoi nën mesataren e BE-së me pothuajse 60% (Eurostat, 2020). Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë, një matës i aktivitetit ekonomik, gjithashtu shënon diferenca të konsiderueshme midis vendeve të BE-së dhe veçanërisht vendeve të cilat synojnë të anëtarësohen në BE. Në këtë aspekt, PBB-ja e Shqipërisë është sa 31% e mesatares së BE-së (po aty). Këto dy tregues janë shumë të rëndësishëm dhe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë për strehimin, strehimin social dhe përballueshmërinë e strehimit. Sigurimi i strehimit social është prioritet i programit të qeverisë 2021–2025. Duke iu referuar shpenzimeve për programet e strehimit, numri i familjeve që kanë përfituar subvencione është në rritje. Bazuar në shpenzimet (burimi i të dhënave: Ministria e Financave dhe Sistemi i Thesarit), qeveria qendrore ka shpenzuar rreth 6,9 miliard lekë për banesat sociale në periudhën 2021–2022 (krahasuar me 1,9 miliardë lekë në 2016–2020) dhe numri i familjeve përfituese ka qenë 21.914.

Punësimi është qartësisht një parakusht thelbësor për përfshirjen sociale. Sipas INSTAT-it (2022), në tremujorin e dytë 2023, shkalla zyrtare e

[7] Strategjia për punësim dhe aftësi 2014–2020", 2014, f. 6.

[8] INSTAT (2013).

[9] Shkalla e varfërisë në Shqipëri 1996–2022 | MacroTrends.

[10] INSTAT, 2022.

[11] *World Bank, Western Balkans Regular Economic Report*: Spring 2022; Banka Botërore, Raporti Ekonomik Periodik për Ballkanin Perëndimor.

[12] "Strategjia për punësim dhe aftësi" 2023–2030, f. 7.

papunësisë në Shqipëri është 10,7%. Shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,4 pikë përqindje, në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2022. Në tremujorin e dytë të vitit 2023 shkalla e punësimit të të rinjve është 44,1%. Ky tregues nuk ka ndryshuar krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 22,3%, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2022 ishte 20,2%, pra është rritur me 2,1 pikë përqindje. [13] Në 2023, tremujori i dytë, të rinjtë e moshës 15–29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 71,6% të të rinjve ekonomikisht joaktivë. Ndër të rinjtë e moshës 15–29 vjeç ekonomikisht joaktivë, 2,6% klasifikohen si të papunë të dekurajuar. Sipas INSTAT-it, të rinjtë e moshës 15–24 vjeç jo të arsimuar dhe jo të punësuar, tregues që vlerëson segmentin e të rinjve më të rrezikuar për t'u margjinalizuar nga tregu i punës, ishte në 24,0% në vitin 2021.[14] Sipas INSTAT-it (2023), shkalla e punësimit për burrat e grup-moshës 15–64 vjeç është 72,6%, ndërsa për gratë është 62,3%. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, shkalla e punësimit është rritur për burrat me 1,7 pikë përqindje, ndërsa për gratë është rritur me 4,1 pikë përqindje. Shkalla zyrtare e papunësisë për burrat është 11,0% dhe për gratë 10,4%. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, shkalla e papunësisë është rritur me 0,3 pikë përqindje për burrat dhe është ulur me 1,0 pikë përqindje për gratë. (INSTAT, 2023). Përfshirja e njerëzve vulnerabël në tregun e punës është një sfidë. Të kesh punë të paguar është një nga mënyrat më të mira për njësitë familjare për të fituar të ardhurat e tyre në tregun e ekonomive dhe për të mos rënë në varfëri.

Sipas reformës së re, **Arsimi dhe Formimi Profesional** (AFP) është përgjegjësi e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Synimi është që të garantohet që politikat për AFP-në dhe politikat për punësimin dhe mbrojtjen sociale të harmonizohen ngushtë. Për këtë arsye, arsimi profesional tashmë është përparësi e qeverisë, por sistemi i arsimit profesional duhet të vijojë të përshtatet me nevojat e tregut duke nxjerrë nxënës të kualifikuar që plotësojnë nevojat në rritje të ekonomisë. Statistikat e regjistrimeve në arsim për vitin 2021–2022 tregojnë se në arsimin zyrtar u regjistruan 577.869 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 2,0%, krahasuar me vitin shkollor 2020–2021, nga të cilët 21,4% në arsimin e lartë, 17.9% në arsimin e mesëm dhe 48.1% arsimin 9-vjeçar dhe 12.5% në kopshte. Gjatë vitit 2021–2022 u regjistruan 453.989 nxënës dhe fëmijë në arsimin parauniversitar, duke shënuar një ulje prej 2,5%, krahasuar me vitin shkollor 2020–2021, dhe në arsimin e mesëm 103.467 nxënës, duke shënuar një ulje prej 4,2% krahasuar me vitin shkollor 2020–2021. Në vitin akademik 2021–2022 vajzat përbëjnë 47,7% të arsimit 9-vjeçar, dhe 59,3% e numrit të përgjithshëm të studentëve në programet e arsimit të lartë.[15]

Qeveria e Shqipërisë hartoi një përgjigje efektive ndaj pandemisë së COVID-19 me një shkallë të vaksinimit të plotë prej 44,24%.[16] Megjithatë, qeveria e Shqipërisë është e vetëdijshme se **shërbimi i kujdesit shëndetësor** është një shërbim publik që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme për të parandaluar, diagnostikuar, trajtuar dhe rehabilituar me efikasitet.[17] Disa fusha të kujdesit shëndetësor mbulohen më mirë se sa të tjerat. Në fushën e kujdesit për nënën e fëmijën, për shembull, mbulimi me shërbim është pothuaj universal. Pothuaj të gjitha gratë shtatzëna (97%) kanë marrë kujdes përpara lindjes nga një ofrues shërbimi i kualifikuar të paktën një herë gjatë shtatzënisë.[18] Pothuaj të gjitha gratë që kanë kryer një lindje të gjallë kanë marrë kujdes para lindjes (97%) dhe ndihmë gjatë lindjes (99%) nga një profesionist i shëndetit dhe 83% e këtyre grave kanë marrë kujdes postnatal brenda dy ditësh pas lindjes.

Të drejtat e njeriut përfshijnë zotërimin e dokumenteve personale dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, të cilat janë çështje kryesore të përfshira në DPPS. Kjo për shkak se ekziston një lidhje e fortë ndërmjet aksesit në sistemin e drejtësisë dhe përfshirjes sociale, sidomos kur bëhet fjalë për grupe vulnerable apo individ dhe komunitete që banojnë në zona rurale. Pabarazitë sociale (gjinore, etnike, vendbanimi, aftësia e kufizuar) ndikojnë në aksesin e individit dhe komunitetit në sistemin e drejtësisë.

[13] https://www.instat.gov.al/media/12503/anketa-tremujore-e-forcave-t%C3%AB-pun%C3%ABs-t2-2023.pdf.

[14] https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/papun%C3%ABsia-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/.

[15] https://www.instat.gov.al/media/9773/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2021-2022.pdf.

[16] Shkalla e vaksinimit të plotë kundër Koronavirusit në Shqipëri (ycharts.com).

[17] Shihni: *Programi i qeverisë*: Shërbimet publike, i disponueshëm në: http://www.kryeministria.al/en/program/public-service.

[18] Po aty, f. 30.

Aksesi në drejtësi dhe pabarazitë janë të ndërlidhura dhe me aksesin. Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë duhet të jetë hapi i parë drejt një objektivi më të madh, i cili është fuqizimi ligjor i grupeve të përjashtuara nga pikëpamja sociale. Fuqizimi ligjor përkufizohet si "përdorimi i ligjit për të rritur kontrollin që ushtrojnë popullsitë në nevojë mbi jetët e tyre."[19] Vëmendja nuk duhet të jetë vetëm në përmirësimin e aksesit në sistemin e drejtësisë, por edhe në rritjen e kapacitetit të njerëzve për të kuptuar dhe përdorur ligjin.[20] Pavarësisht procedurave formale që ekzistojnë për administrimin e sistemit të ndihmës juridike, në praktikë mungesa e informacionit dhe e aksesit në sistem çon në raste ku mangësitë në zbatimin e sistemit të drejtësisë krijojnë pengesa të konsiderueshme për zbatimin e politikave të përfshirjes sociale. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2030, parashikon ndër objektivat përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga gjykatat në vend.

Përkundrejt sfondit të kësaj panorame të politikave, DPPS fokusohet në çështje që nevojitet të maten dhe monitorohen në përputhje me kuadrot konceptuale dhe standardet statistikore të krijuara në nivel BE-je në gjashtë fusha: 1. ulja e varfërisë dhe mbrojtja sociale; 2. punësimi dhe aftësitë; 3. arsimi dhe formimi; 4. shëndeti; 5. nevojat bazë; dhe 6. të drejtat e njeriut. Shihni figurën nr. 2.

Figura nr. 2. Fushat e politikave për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale

1.1 Strukturat e koordinimit për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri

Një detyrë e rëndësishme në Shqipëri është pjesëmarrja në Procesin e Përfshirjes Sociale. Për të realizuar këtë gjë, nevojitet një zhvillim dhe përmirësim i mëtejshëm i kuadrit institucional për monitorimin e përfshirjes sociale. Kjo qasje duhet të mbështetet, por gjithashtu të shkojë përtej përmbajtjes së Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2024–2028 dhe Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (SKMS) 2024–2030.

Si një strategji ndërsektoriale, SKMS-ja është hartuar të jetë në harmoni me politikat specifike të sektorëve dhe Mekanizmave institucionalë që kanë si synim të mbështesin individët, familjet, dhe grupet në nevojë në nivel komuniteti.

Për shkak të nevojës për një sistem të integruar, gjithëpërfshirës dhe të përmirësuar për menaxhimin e të gjithë ciklit të politikave në sektorët kyçë, qeveria e Shqipërisë ka krijuar Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) për të udhëhequr hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, për të drejtuar dhe monitoruar zhvillimin e politikave, zbatimin dhe vlerësimin e strategjisë, si dhe rritjen e koordinimit ndërmjet sektorit dhe donatorëve. Misioni i SASPAC-ut është koordinimi i ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, të ndihmojë strukturat vendimmarrëse në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe monitorimi i zbatimit të saj, ofrimi i mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar dhe ofrimi i mbështetjes për institucionet e administratës shtetërore me qëllim rritjen e kapaciteteve në fushën e programeve dhe projekteve zhvillimore. Kjo agjenci do të mbështesë gjithashtu procesin e integrimit në BE.

Monitorimi i përfshirjes sociale dhe përshtatja e sistemit të matjes me standardet e BE-së përfaqëson një nga kushtet për anëtarësimin në BE. Qeveria e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave, kanë

[19] http://asiafoundation.org/resources/pdfs/LegalEmpowerment.pdf, f. 9.

[20] http://www.namati.org/publications/what-do-we-know-about-legal-empowerment-mapping-the-evidence/, f. 8.

prezantuar Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), e cila mundëson përparimin e sistemit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për situatën e grupeve dhe individëve të ndryshëm që vuajnë nga përjashtimi social dhe fillimin e procesit të harmonizimit të monitorimit të treguesve të përfshirjes sociale me vendet e BE-së.

Në përputhje me tendencat e harmonizimit me statistikat evropiane, Republika e Shqipërisë realizon anketime mbi standardet e jetesës së popullsisë duke përdorur Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ). Anketa AANJ është kthyer në një burim kryesor të të dhënave për varfërinë dhe përjashtimin social dhe ka zëvendësuar Anketën për Matjen e Nivelit të Jetesës (AMNJ), e cila është përdorur për këto qëllime në të shkuarën.[21] Analiza e të dhënave të AANJ-së bën të mundur monitorimin e kompleksitetit të dukurisë së përjashtimit, pra natyrën shumë-dimensionale dhe kohëzgjatjen e përjashtimit social. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për t'iu përgjigjur siç duhet aspekteve të ndryshme të përjashtimit social dhe zgjidhjes së këtij problemi përmes ndërhyrjeve dhe politikave të krijuara për grupe të veçanta në nevojë. AANJ mundëson monitorimin e të njëjtës popullatë gjatë një periudhe më të gjatë, gjë që lejon monitorimin e statusit të grupeve dhe individëve të caktuar.

Sistemi i monitorimit të përfshirjes sociale duhet të përfshijë aspekte të ndryshme të ndarjes së të dhënave, sepse llojet dhe intensiteti i përjashtimit janë të shpërndara në mënyrë shumë të pabarabartë në kategori të ndryshme sociale. Në këtë mënyrë, do të ishte më e lehtë të përshtateshin ndërhyrjet dhe politikat në përputhje me karakteristikat e grupeve në nevojë. Raporti vjetor *Matja e Përfshirjes Sociale në Shqipëri* përmban kriteret për ndarjen e të dhënave: gjinia, mosha, niveli arsimor, punësimi, përkatësia etnike, statusi i personave me aftësi të kufizuara, lloji i vendbanimit, rajoni i Shqipërisë, të ardhurat, niveli arsimor i nënës, punësimi i nënës, madhësia e familjeve, numri i fëmijëve në një familje dhe izolimi fizik.

AANJ do të mbledhë të dhëna mbi të ardhurat e gjeneruara në vitin e mëparshëm kalendarik dhe kjo do të bëjë të mundur monitorimin e aktivitetit ekonomik të personave gjatë të gjithë periudhës 12-mujore. Gjithashtu, AANJ do të garantojë matje të saktë të varfërisë dhe përfundime të besueshme, veçanërisht për sa i përket periudhave kohore. Kjo anketë do të regjistrojë ndryshimet që do të ndodhin në të gjitha njësitë kampion gjatë të gjithë vitit.

Me synimin për të përmirësuar sistemin e monitorimit dhe matjen e të gjitha dimensioneve të përjashtimit social, sistemi i mbledhjes së të dhënave të mbrojtjes sociale në nivel administrativ (ESSPROS), tashmë funksionon duke u mbështetur në sistemin bazë të të ardhurave dhe shpenzimeve në fushën e mbrojtjes sociale - bazuar në skemat e mbrojtjes sociale dhe modulin për përfituesit e pensioneve, të cilat janë në përputhje të plotë me standardet e BE-së.

Hapi i parë në harmonizimin e sistemit mund të jetë reflektimi i procesit të vlerësimit që lidhet me tërësinë e legjislacionit të BE-së (*acquis communautaire*). Duhet të realizohet një analizë e nivelit aktual të përafrimit/mospërputhjes së standardeve në sistemin e administratës në Shqipëri me standardet e BE-së, duke marrë në konsideratë ngritjen e kapaciteteve shtesë dhe zgjidhjet institucionale për krijimin e sistemit ESSPROS. Për më tepër, do të jetë shumë e rëndësishme që të ketë udhëzime të qarta, veçanërisht për realizimin e anketave cilësore, me qëllim që të përftohet një ide sa më e qartë që të jetë e mundur mbi treguesit specifikë të përfshirjes sociale dhe një përkufizim shtesë mbi sistemin e monitorimit të treguesve specifikë në vend.

Përmirësimi i sistemit të statistikave dhe nxitja e bashkërendimit të institucioneve të ndryshme të sistemit janë gjithashtu parakushte për krijimin e një sistemi monitorimi funksional në Republikën e Shqipërisë dhe për harmonizimin e tij me atë të shteteve anëtare të BE-së. Të dhënat për përfshirjen sociale dhe varfërinë duhet të paraqesin një panoramë sistematike dhe të paanshme të situatës aktuale në Shqipëri dhe duhet të shërbejnë si bazë për: krijimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi; harmonizimin e kuadrove ligjore dhe prioriteteve strategjike në fushat përkatëse; zhvillimin e ndërhyrjeve të ardhshme për zvogëlimin e përjashtimit social dhe uljen e varfërisë në vend.

Analiza e situatës aktuale të përjashtimit social dhe varfërisë në Shqipëri duhet të mbështetet mbi treguesit e BE-së që pasqyrojnë situatën në katër dimensione bazë: varfëria, punësimi, arsimi dhe

[21] http://www.instat.gov.al/media/8364/income-and-living-condition-2019.pdf.

shëndetësia. Gjithashtu, analiza do të fokusohet te treguesit që duhet të monitorohen në nivel kombëtar: mosplotësimi i nevojave bazë dhe të drejtat e njeriut. Burimet kryesore të të dhënave janë të dhënat zyrtare nga Instituti i Statistikave, të dhënat statistikore, si dhe institucionet referencë për mbledhjen e të dhënave në sektorët e mbrojtjes sociale, punësimit dhe mbështetjes së biznesit, shëndetësisë, arsimit, strehimit dhe nevojave bazë, si dhe pjesëmarrjes dhe të drejtave të njeriut.

2. Vizioni, politikat dhe prioritetet strategjike

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) 2024–2028 shpreh vizionin, fushën e zbatimit dhe objektivat për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale dhe i shndërron ato në një plan veprimesh të prioritizuara. Dokumenti specifikon përgjegjësitë për zbatimin e strategjisë dhe përfshin një grup standardesh krahasuese për monitorimin e rezultateve.

Vizioni i DPPS-së është të garantojë një sistem për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të uljes së varfërisë dhe të mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive për sipërmarrjen, arsimit dhe formimit, shëndetit, strehimit, nevojave bazë dhe të drejtave të njeriut; si dhe të nxisë transparencën dhe llogaridhënien mbi mënyrën se si matet dhe përdoret përfshirja sociale për të mbështetur me informacione performancën e shërbimeve sociale.

Objektivi i përgjithshëm i DPPS-së është arritja e një kuadri të balancuar dhe të qëndrueshëm për të rritur besimin e publikut te mënyra se si matet dhe raportohet përfshirja sociale në Shqipëri me anë të një grupi treguesish të shëndoshë të BE-së dhe kombëtarë, si dhe të përmirësojë mënyrën e lidhjes së përfshirjes sociale me përmirësimin e politikave të qeverisë dhe përparimin e Shqipërisë, si një vend kandidat për në BE, drejt qëllimit përfundimtar të anëtarësimit në BE.

DPPS-ja ka tri synime kryesore:

- Të identifikojë dhe trajtojë sfidat me të cilat përballet monitorimi dhe matja e përfshirjes sociale duke përmirësuar treguesit kombëtar me qëllim që të jenë të krahasueshme me ato të BE që janë të nevojshëm për të mbështetur uljen e varfërisë dhe zhvillimin e masave efikase që rrisin mirëqenien;

- Të nxisë koherencën e politikave, të vendosë përparësitë dhe të përcaktojë përgjegjësitë për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale, me fokus dimensionin gjinorë, përkatësinë etnike, paaftësinë, vendbanimin;

- Të rrisë transparencën e ndikimit që kanë pasur politikat e ndjekura, si dhe të rrisë transparencën e përpjekjeve të bëra nga qeveria për forcimin e politikave që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

- Pjesa më e madhe e DPPS-së mbështetet në strategji dhe plane veprimi më të hollësishme, të tilla si:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022–2030);

- Dokumenti i politikave prioritare 2024–2026[22];

- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2024–2030);

- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021–2025);

- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (2021–2025);

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021–2030);

- Strategjia Kombëtare e Strehimit Social (2016–2025);

- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë (2021–2030);

- Strategjia Kombëtare e Arsimit (2021–2026);

- Strategjia Kombëtare për Kulturën (2019-2025);

- Strategjia Kombëtare e Rinisë (2022–2029);

- Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit (2021–2030);

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (2023–2030);

- Plani Kombëtar i Veprimit për Promovimin e Shëndetit (2021–2030);

- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2022–2026);

- Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë për të mitur (2022–2026);

- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021–2027);

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (2021–2025)[23].

[22] VKM-ja nr. 447, datë 26.7.2023, "Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2024–2026".

[23] DPPS-ja mban në vëmendje edhe zhvillimet e synuara të qeverisë në fushën e politikave si për shembull ato në fushën e drejtësisë si p.sh. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, dhe Plani i Veprimit 2024–

Për më tepër, DPPS plotësohet me masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe shpeshtësisë së Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF), Anketës së Forcave të Punës (AFP), Anketës për Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) dhe qasjen me Sistemin e Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (ESSPROS). Në këtë dokument pasqyrohet rëndësia që kanë këto anketa për përfshirjen sociale.

Në vijim të DPPS 2016–2020, Dokumenti aktual i Politikave të Përfshirjes Sociale për periudhën 2024–2028, synon të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin dhe koordinimin e institucioneve publike duke prodhuar në vazhdim rezultate të matshme për mirëqenien sociale dhe ekonomike.

Dokumenti përmban masa të zbatueshme që shkojnë përtej koncepteve dhe planeve. Për këtë arsye, standardet krahasuese të monitorimit me standardet e BE dhe OZHQ, me bazë objektivat dhe performancën konsiderohen kyçe për të garantuar një monitorim të detajuar mbi zbatimin e masave dhe treguesve, interpretimin dhe transparencën për rezultatet e politikave të përfshirjes sociale.

Metodologjia e DPPS-së për monitorimin e përfshirjes sociale synon të garantojë si krahasueshmërinë e treguesve kryesorë të përfshirjes sociale me ato të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve që janë aktualisht në proces anëtarësimi në BE, me OZHQ, si dhe të japë informacion mbi specifikat e problemeve të përfshirjes sociale që rrjedhin nga procesi i veçantë i tranzicionit në Shqipëri.

Në vitin 2015, qeveria e Shqipërisë miratoi krijimin e Grupeve për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), si një qasje novatore për të drejtuar dhe monitoruar zhvillimin e politikave, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive, si dhe rritjen e bashkërendimit sipas sektorëve me partnerët strategjikë. Mekanizmi i GMIP-së, i cili bazohet në Sistemin e Integruar të Politikave (SIP), synon t'i japë Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS) dhe komiteteve të tjera qeveritare të nivelit të lartë, për shembull, Komitetit Ndërministror për Bashkë-rendimin e Integrimit Evropian, rekomandimet e nevojshme për vendimet kyçe të politikave që ndikojnë në sektorët e konsideruar si prioritarë dhe për të cilat kërkohet bashkëpunim ndërministror.

Në këtë kontekst, në vitin 2015, u krijua një GMIP për sektorin e punësimit dhe atë social, i cili përfshin grupe tematike që mbulojnë punësimin dhe aftësitë, pensionet dhe sigurimet shoqërore, programe të ndryshme të ndihmës sociale dhe shërbime të kujdesit social, si dhe përfshirjen sociale. Në vitin 2023, GMIP përgjegjëse për sektorin e punësimit dhe përfshirjes sociale ishte GMIP "Zhvillimi i kapitalit njerëzor", i drejtuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë,[24] tashmë nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit[25].

Koncepti në themel të Mekanizmit të GMIP-së është t'i japë qeverisë shqiptare një sistem të integruar, gjithëpërfshirës dhe të përmirësuar për menaxhimin e ciklit të përgjithshëm të politikave në sektorët kyç, në mënyrë që të përmbushen objektivat e programit të qeverisë dhe të përdoren në mënyrë sa më efektive dhe efikase burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare.

GMIP përfiton nga mbështetja teknike, menaxheriale dhe administrative që ofrohet nga një sekretariat i GMIP-së. Ky sekretariat i posaçëm, i cili duhet të shoqërohet me kapacitetet e duhura, është një veçori e rëndësishme e sistemit të GMIP-së. Krahas kryetarit të GMIP-së, sekretariati ka rëndësi vendimtare për suksesin e tij.

GMIP këshillon, udhëzon dhe bashkërendon institucionet e përfshira në sektorin e punësimit dhe atë social, siguron arritjen e marrëveshjeve për çështjet kyçe që lidhen me këtë sektor, miraton rezultatet e punës së realizuar nga aktorë të ndryshëm dhe jep rekomandime për vendimmarrësit në nivele të larta.

Gjatë periudhës së zbatimit DPPS paraqitur në mënyrë të përmbledhur, prioritetet kryesore tematike të mëposhtme:

- Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS) për të siguruar qëndrueshmërinë në përkufizime dhe në përdorimin e treguesve.

- Garantimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave administrative për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike, orientimin seksual dhe aftësinë e kufizuar.

2030, si dhe Strategjia Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur, Planit të Veprimit 2022–2026, etj.

[24] Urdhri i kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

[25] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.1.2024, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit".

- Përgatitja dhe botimi i një fjalori tematik me termat e përfshirjes sociale, i cili do të shpërndahet në të gjitha institucionet publike, institutet kërkimore dhe organizatat joqeveritare.

- Hartimi dhe zbatimi i anketave cilësore periodike/tematike për përfshirjen sociale në Shqipëri, të cilat fokusohen tek intensiteti, shkaqet dhe llojet e përjashtimit social.

- Përgatitja e një raporti vjetor për përfshirjen sociale në Shqipëri, mbështetur në anketat dhe të dhënat cilësore ekzistuese dhe të ardhshme.

- Nxitja e dialogut mbi politikat për përfshirjen sociale në Shqipëri përmes një kalendari aktivitetesh dhe një konference kombëtare të përvitshme për përfshirjen sociale, si dhe përmes veprimtarive periodike.

- Krijimi i një Strukture Burimore Teknike (SBT) për analizën e përfshirjes sociale dhe varfërinë.

Gjithashtu, janë tri prioritete të DPPS-së në nivel të përgjithshëm:

- Përmirësimi i njohurive të administratës publike, për të realizuar një analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të përfshirjes sociale dhe zbatimin e politikave përkatëse.

- Ngritja e kapaciteteve dhe ofrimi i trajnimeve me synim të qartë forcimin e kapaciteteve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, si dhe për të garantuar që përfshirja sociale është pjesë përbërëse e politikave në nivel kombëtar dhe vendor.

- Një strategji komunikimi për përfshirjen sociale që merr në konsideratë të gjitha nivelet e qeverisjes, sektorin privat dhe aktorët e shoqërisë civile.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Dokumenti i Politikave përqendrohet në aktivitetet dhe masat për arritjen e një kuadri të balancuar dhe të qëndrueshëm rreth mënyrës se si matet, monitorohet dhe raportohet përfshirja sociale në Shqipëri, duke përdorur një grup treguesish të konsoliduar në nivel të BE-së dhe në nivel kombëtar. Ky dokument dhe plani i tij i veprimit synon të sjellë përmirësime në mënyrat përmes të cilave përfshirja sociale lidhet me politikat e qeverisë dhe me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Veprimtaritë e parashikuara në DPPS përqendrohen në:

- Forcimin e kapaciteteve në nivelin e qeverisjes qendrore për të bashkërenduar, monitoruar dhe ofruar udhëzime rreth përfshirjes sociale;

- Rritjen e kapaciteteve të ministrive të linjës për të hartuar, planifikuar dhe zbatuar politikat e përfshirjes sociale si pjesë e veprimtarive të tyre periodike;

- Përmirësimin e sistemit statistikor të Shqipërisë për monitorimin e treguesve të përfshirjes sociale;

- Përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe vendor në planifikimin dhe zbatimin e politikave të përfshirjes sociale, në përputhje me parimin e subsidiaritetit;

- Ofrimin e mbështetjes për pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në bashkëpunime rajonale, si dhe për të garantuar se përpjekjet e vendit në fushën e përfshirjes sociale njihen dhe mbështeten nga Komisioni Evropian.

Rezultatet e pritshme të Strukturës Burimore Teknike (SBT), janë:

- Zhvillimi, miratimi dhe përfshirja e politikave të përfshirjes sociale në strategjitë sektoriale dhe kuadrin ligjor/strategjitë e politikave kombëtare brenda vitit 2028;

- Harmonizimi/integrimi i raportimit për përfshirjen sociale në raportimin e rregullt të qeverisë, në kuadër të diskutimit të politikave të saj me BE-në mbi përparimin e bërë në përfshirjen sociale;

- Ulja e varfërisë dhe margjinalizimit përmes burimeve dhe bazuar në shtimin e njohurive mbi llojet, shkaqet dhe intensitetin e përfshirjes sociale.

Përparësitë kryesore tematike gjatë periudhës afatmesme paraqiten në mënyrë të përmbledhur në pikat e mëposhtme:

- Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS) për të siguruar qëndrueshmërinë në përkufizime dhe në përdorimin e treguesve;

- Garantimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave administrative për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar.

- Përgatitja dhe botimi i një fjalori tematik me termat e përfshirjes sociale, i cili do u shpërndahet të gjitha institucioneve publike, instituteve kërkimore dhe organizatave joqeveritare;

- Hartimi dhe zbatimi i anketave cilësore periodike/tematike për përfshirjen sociale në Shqipëri, të cilat fokusohen tek intensiteti, shkaqet dhe llojet e përjashtimit social;

- Përgatitja e një raporti vjetor për përfshirjen sociale në Shqipëri, mbështetur në anketat dhe të dhënat cilësore ekzistuese dhe të ardhshme;

- Nxitja e dialogut mbi politikat për përfshirjen sociale në Shqipëri përmes një kalendari aktivitetesh dhe një konference kombëtare të përvitshme për përfshirjen sociale, si dhe përmes veprimtarive periodike;

- Kryerja e një analize institucionale për të përmirësuar mënyrat e menaxhimit të përfshirjes sociale nga qeveria dhe të integrimit të saj në sistemet qeveritare;

- Krijimi i një kuadri strategjik, i cili do të udhëheqë masat që do të mbështesin analizën e të dhënave të anketës AANJ-së në nivel vendor;

- Krijimi i një Strukture Burimore Teknike (SBT) për analizën e përfshirjes sociale dhe varfërisë.

Ekzistojnë një sërë përparësish, që janë pjesë e të gjithë gamës së prioriteteve për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale:

- Një administratë profesionale, me aftësi më të mira teknike, për të realizuar një analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të përfshirjes sociale dhe zbatimin e politikave përkatëse;

- Ndërhyrje trajnuese me fokus të qartë, të cilat do të forcojnë kapacitetet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor, për të garantuar se përfshirja sociale është pjesë përbërëse e politikave në nivel kombëtar dhe vendor;

- Një strategji komunikimi për përfshirjen sociale që merr në konsideratë nevojat e qeverisë, të sektorit privat dhe të aktorëve të shoqërisë civile.

2.2 Instrumentet

Vizioni i një sistemi modern dhe efikas për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri do të arrihet përmes zbatimit të disa instrumenteve: ngritja e kapaciteteve, Struktura Burimore Teknike (SBT) dhe rikonceptimi apo riorganizimi i proceseve.

Ecuria e matjes dhe monitorimit të përfshirjes sociale kërkon investime të konsiderueshme në kapacitete njerëzore. Ngritja e kapaciteteve teknike realizohet përmes disa mënyrave: programe trajnimi të vazhdueshme dhe të posaçme, transferim aftësish në kuadër të programeve të binjakëzimit me organizatat simotra përgjegjëse për politikat e përfshirjes sociale në shtetet anëtare të BE-së, vizita studimore në vende të tjera që po përgatisin dhe zhvillojnë instrumente dhe politika të përfshirjes sociale, rotacion në punë etj. Në veçanti, qeveria do të kërkojë mbështetje nga partnerët e saj për hartimin dhe financimin e shumë prej programeve të trajnimit.

2.2.1 Ndryshime në menaxhimin e procesit dhe në kulturën analitike drejt përfshirjes sociale

Shqipëria i ka hyrë një rruge të gjatë, e cila do të zhvendosë fokusin e përfshirjes sociale nga një ide konceptuale në një praktikë për zbatimin e përfshirjes sociale në politika dhe gjenerimin e rezultateve më të mira. Kornizat konceptuale janë krijuar në përgjithësi bazuar në dokumentin e politikave dhe strategjinë e mëparshme, të cilat e trajtonin nocionin e përfshirjes sociale si një çështje ndërsektoriale. Për zbatimin e strategjisë së mëparshme, u hartua një plan pesëvjeçar për periudhën 2007–2013. Synimi i dokumentit ishte t'i paraqiste qeverisë një drejtim strategjik në një mënyrë të integruar dhe të ofronte një kuadër monitorimi mbështetur në përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale (PKVPS), i cili, në atë kohë, ishte një kërkesë standarde për anëtarësimin në BE. Megjithatë, zbatimi i planit në nivel kombëtar PKVPS-të. Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2016–2020, u fokusua kryesisht te monitorimi i përfshirjes/përjashtimit social përmes grumbullimit të të dhënave nga institucionet publike.

Përmbushja e vizionit për të pasur një sistem modern dhe efikas për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale do të kërkojë investime të konsiderueshme për përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe organizative të Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore (DPPSBGJ në MSHMS).

Me mbështetjen e funksioneve të përfshirjes sociale në administratën publike, përdorimi i treguesve në nivel të BE-së dhe në nivel kombëtar për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale, si dhe përdorimi i anketave AANJ, Anketave të Buxhetit të Familjes (ABF) dhe Anketave të Forcave të Punës (AFP), dhe të statistikave të tjera nga burime administrative (ESSPROS), do të mundësojë vlerësimin e performancës dhe rezultateve të politikave. Gjithashtu, do të duhet të bëhen përpjekje për të garantuar integrimin vertikal dhe horizontal të tematikave dhe çështjeve specifike në analizën më të gjerë të përfshirjes sociale.

Qeveria do të ftojë partnerët për zhvillim që të ndihmojnë në formulimin e këtij ndryshimi organizativ dhe kulturor drejt matjes dhe monitorimit të përfshirjes sociale.

2.3 Objektivat e politikave dhe arritjet kryesore

2.3.1 Shtylla A: Sisteme të qëndrueshme për përfshirjen sociale

Konteksti i politikave

Qeveria do të shfrytëzojë mundësitë e krijuara nga përdorimi i anketave periodike AANJ, Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF), Anketës së Forcave të Punës (AFP) dhe ESSPROS, për të krijuar një sistem të besueshëm dhe të qëndrueshëm për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale, duke përdorur treguesit në nivel të BE-së dhe ato në nivel kombëtar. Do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS) për të siguruar qëndrueshmërinë në përcaktimin dhe në përdorimin e treguesve në nivel BE-je dhe në nivel kombëtar;

- Rishikimi, publikimi dhe shpërndarja në mënyrë periodike e fjalorit tematik me termat e përfshirjes sociale, i cili do u shpërndahet të gjitha institucioneve publike, instituteve kërkimore dhe organizatave joqeveritare në Shqipëri;

- Marrja e masave për të garantuar se të dhënat administrative për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike, dhe aftësinë e kufizuar mblidhen, analizohen dhe përfshihen rregullisht në raportet vjetore të përfshirjes sociale.

Krijimi i një Strukture Burimore Teknike (SBT) për analizën e përfshirjes sociale dhe varfërisë.

2.3.1.1 Treguesit statistikorë

Konteksti

Futja e treguesve të nivelit të BE-së dhe të nivelit kombëtar për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale është një sipërmarrje e vështirë dhe kërkon një vështrim retrospektiv në anketat ekzistuese dhe në të dhënat administrative në gjashtë fushat e politikave, një Mekanizëm për të qenë gjithnjë në korent të politikave të përditësuara dhe risive statistikore në metodologjitë e përfshirjes sociale, si dhe integrimin e metodologjive për të garantuar integrimin e variablave kyçë si gjinia, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, vendndodhja hapësinore, lloji i vendbanimit, etj.

Grupi Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale që do të krijohet, ku do të bëjnë pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, do të marrë përsipër detyrën e hartimit të standardeve, përkufizimeve, burimeve të të dhënave dhe treguesve për të matur dhe monitoruar përfshirjen sociale. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat specifikë, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Përpunimi i të dhënave statistikore	Tregues të besueshëm dhe të mbështetshëm, me përkufizime të qarta dhe burime të identifikueshme të dhënash. Zyrtarë qeveritarë të trajnuar në matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale.	Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS); Përpunimi i standardeve, përkufizimeve, burimeve të të dhënave dhe treguesve për përfshirjen sociale; Zyrtarë qeveritarë të trajnuar në matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale.	Hartimi i termave të referencës për GNSPS; Identifikimi i anëtarëve të GNSPS-së; Realizimi i mbledhjeve të GNSPS-së dhe përfshirja e rezultateve në raportin vjetor të përfshirjes sociale; Rekrutimi i konsulentëve ndërkombëtarë dhe vendas për të ndihmuar GNSPS-në; Kryerja e një vlerësimi për nevojat për trajnim të anëtarëve të GNSPS-së; Hartimi i një pakete trajnimi mbi përfshirjen sociale për anëtarët e GNSPS-së; Zhvillimi i sesioneve të trajnimit[26] mbi përfshirjen sociale me anëtarët e GNSPS-së.	1

[26] Sesionet e trajnimit do të trajtojnë çështje, të tilla si: Çfarë është përfshirja sociale? Cilat metoda përdoren për mbledhjen e të dhënave mbi përfshirjen sociale? Si mblidhen të dhënat? Tematikat që do të mbulohen gjatë sesioneve të trajnimeve do të bazohen në rezultatet e vlerësimit të nevojave.

2.3.1.2 Fjalori

Konteksti

Me shndërrimin e përfshirjes sociale në Shqipëri nga një kornizë konceptuale në një grup veprimesh operacionale, do të rritet nevoja për të kuptuar më mirë metodat sasiore dhe cilësore që shoqërojnë përdorimin e tyre, për të pasur një saktësi më të madhe në përdorimin e treguesve dhe për të kuptuar më mirë teknikat statistikore që lidhen me matjen e përfshirjes sociale. Në mënyrë që hartuesit e politikave, akademikët, institutet kërkimore dhe aktorët e shoqërisë civile të angazhohen në dialogun mbi përfshirjen sociale, fjalori do të përditësohet dhe botohet në anglisht dhe në shqip. Fjalori do të duhet të përditësohet në intervale të rregullta për të pasqyruar ndryshimet dhe shtesat në terminologji, teknika dhe përkufizime. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Fjalori i përditësuar	Përmirësimi i të kuptuarit të terminologjisë statistikore dhe metodologjike në fushën e përfshirjes sociale.	Botimi dhe ribotimi i fjalorit, në mënyrë periodike, çdo dy vjet.	Angazhimi i një konsulenti vendas për të përditësuar fjalorin; Përditësimi i fjalorit një herë në dy vjet me mbështetje nga konsulenti.	1

2.3.1.3 Të dhënat administrative

Konteksti

Të dhënat administrative zakonisht nuk dokumentojnë statusin e gjinor, të përkatësisë etnike dhe statusin e aftësisë së kufizuar të njerëzve që përdorin shërbimet publike. Në kontekstin e përfshirjes sociale, kur flitet për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar, nevoja të ndryshme dhe aftësimin që të ndërmarrin një rol të plotë dhe produktiv në familje, komunitet, shoqëri dhe ekonomi, të kenë nën kontroll jetën e tyre, të bëjnë zgjedhjet që dëshirojnë dhe të kenë akses të barabartë dhe të drejtë në shërbime, mbështetje dhe mundësi. Kjo do të thotë se të dhënat kryesorë për shumicën e treguesve në nivel kombëtar, si dhe për disa nga treguesit në nivel BE-je, nuk mund të pasqyrohen qartë. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Përpunimi i të dhënave administrative	Sistemet administrative regjistrojnë të dhëna për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar	Prova të statistikave të përmirësuara për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar të lidhura me treguesit e nivelit kombëtar dhe ato të BE-së.	Kryerja e vlerësimeve të përvitshme të sistemeve që përdoren për të mbledhur të dhëna për gjininë, grup-moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar në të gjitha organet publike – sidomos ato që lidhen me gjashtë fushat e mbuluara nga treguesit në nivel BE-je dhe ato kombëtarë; Vlerësimi do të realizohet nga Struktura Burimore Teknike (shihni më poshtë); Përfshirja e vlerësimit të statistikave mbi gjininë, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar në Raportin Vjetor të Përfshirjes Sociale.	2

2.3.1.4 Struktura Burimore Teknike (SBT)

Konteksti

Deri më tani, investimet publike në aftësi, teknika, kapacitete organizative, ndërgjegjësim të publikut, si dhe në analiza dhe raportime sistematike për përfshirjen sociale kanë qenë minimale. Në kontekstin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, po rritet kërkesa dhe nevoja për aftësi dhe kapacitete organizative për të menaxhuar dhe përpunuar agjendën e përfshirjes sociale. Analiza e planifikimit dhe ndikimit, si dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së Shqipërisë në forumet e përfshirjes sociale në nivel të BE-së, duke përfshirë edhe metodën e hapur të bashkëpunimit (MHB), do të jenë pjesë përbërëse e kuadrit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Parashikohet se do të duhet të krijohet Struktura Burimore Teknike (SBT) për analizat e përfshirjes sociale dhe të varfërisë, nën drejtimin e MSHMS-së, për të dhënë udhëzime, mbështetje dhe këshilla të drejtpërdrejta.

Synimi i përgjithshëm do të jetë zhvillimi i informacioneve dhe përftimi i njohurive më të thella mbi faktorët që ndikojnë te varfëria, përjashtimi social, deprivimi material, rreziku për të qenë i varfër, pabarazia, aksesi në tregun e punës dhe aspekte të tjera me rëndësi për jetën e individëve dhe familjeve në Shqipëri, duke rritur kapacitetet e studiuesve dhe analistëve të politikave me qëllim futjen e metodologjive inovatore dhe realizimin e studimeve dytësore në fushat e politikave, të cilave nuk u është kushtuar vëmendje e mjaftueshme në Shqipëri, por që janë tejet të rëndësishme për të formuluar politika publike efektive, të nxisin studiuesit të përdorin një shumëllojshmëri të burimeve të disponueshme të të dhënave dhe të materialeve studimore ekzistuese, si dhe të promovojnë diskutimin ndërmjet prodhuesve dhe përdoruesve të të dhënave. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Krijimi i Strukturës Burimore Teknike	Përmirësimi i aftësive teknike dhe organizative për mbledhjen, monitorimin, analizimin dhe raportimin e përfshirjes sociale në strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe ndër aktorët e shoqërisë civile. Integrimi i përfshirjes sociale në strategjitë, planet e veprimit, qasjet sektoriale, programet kombëtare sektoriale dhe programet e mbështetjes sektoriale.	Krijimi i Strukturës Burimore Teknike në MSHMS; Me kalimin e kohës, zhvillimi i analizave dhe raportimeve të përmirësuara për përfshirjen sociale në Shqipëri; Krijimi i Mekanizmit për të nxitur dhe mbështetur dialogun mbi politikat për çështjet metodologjike që lidhen me anketën AANJ dhe burimet e tjera të të dhënave; Krijimi i Mekanizmit për të nxitur dhe mbështetur analizën dytësore të të dhënave të AANJ-së dhe të burimeve të tjera të të dhënave; Pjesëmarrja e Shqipërisë në forumet e BE-së, duke përfshirë në MHK, të cilët fokusohen në përfshirjen sociale; Krijimi dhe vënia në funksion e faqes së internetit të SBT-së, si dhe nxitja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit me përfshirjen sociale në Shqipëri dhe në shtetet anëtare të BE-së.	Përgatitja e Termave të Referencës për krijimin e SBT-së; Caktimi i konsulentëve që do të realizojnë vlerësimin paraprak dhe modelin e SBT-së për qëllime të analizave të përfshirjes sociale dhe varfërisë; Vlerësimi i strukturave të qeverisjes për të përcaktuar se ku do të vendoset SBT-ja; Miratimi nga MSHMS-ja i Termave të Referencës funksionalë për Strukturën Burimore Teknike; Krijimi i SBT-së; Krijimi i një faqeje interneti të përshtatshme për SBT-në.	1

2.3.2 Shtylla B: Sisteme efektive për menaxhimin e përfshirjes sociale

Konteksti i politikave

Përfshirja sociale lidhet me zhvillimin strategjik dhe shqyrtimin e politikave të qeverisë. Në praktikë, strategjitë sektoriale nuk e kanë pasur këtë funksion orientues, sepse zakonisht kanë qenë dokumente të shkëputura, jo të integruara dhe shumë pak të lidhura me vlerësimet e burimeve financiare dhe njerëzore që mund të ishin në dispozicion për zbatimin e strategjive. Qeveria do ta ulë këtë risk duke garantuar ndërveprimin e DPPS-së me strukturat e GMIP-së "Zhvillimi i kapitalit njerëzor", drejtuar nga MEKI, ministria përgjegjëse për politikat sociale dhe punësimin.

Masat e parashikuara në kuadër të kësaj shtylle kanë rëndësi të madhe në përmbushjen me sukses të DPPS-së:

- Kryerja e një analize institucionale nga drejtoria përgjegjëse e përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore për të përmirësuar mënyrat e menaxhimit të përfshirjes sociale nga qeveria dhe të integrimit të saj në sistemet qeveritare;
- Përgatitja dhe publikimi i një raporti vjetor për përfshirjen sociale në Shqipëri, mbështetur në anketat dhe të dhënat cilësore ekzistuese dhe të ardhshme.

2.3.2.1 Rregullimet administrative publike për përfshirjen sociale

Konteksti

Politikat dhe monitorimi i përfshirjes sociale hartohen dhe monitorohen nga MSHMS-ja dhe Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore (DPSBGJ). DPSBGJ-ja ka një staf të vogël në numër dhe një buxhet të kufizuar për të ndërmarrë analiza teknike apo për të garantuar integrimin aktiv të përfshirjes sociale në politikat dhe programet e qeverisë.

Sfidat e identifikuara në vlerësime të mëparshme të situatës së përfshirjes sociale duhet të trajtohen në mënyrë sistematike dhe të fuqizohet roli i DPPS në zbatimin e tij.

Krahas sfidave të brendshme me të cilat përballet DPSBGJ-ja, ekzistojnë gjithashtu edhe çështje horizontale, të cilat duhet të trajtohen gjatë zbatimit të këtij plani. Këto kufizime lidhen me kuadrin dhe koordinimin ndërinstitucional dhe rolin e DPSBGJ-së, dhe kufizimet kohore dhe të cilësisë, për të pasur efikasitet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave me një proces gjithëpërfshirës me ministritë e linjës, agjencitë dhe departamentet që nuk janë në fushën e mbulimit të MSHMS-së. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Fuqizimi i rregullimeve administrative publike për përfshirjen sociale	Menaxhim publik efektiv dhe efikas.	Sigurimi i stafit të mjaftueshëm, i buxhetit të arsyeshëm për funksionimin dhe krijimin e një njësie për menaxhimin dhe koordinimin e përfshirjes sociale që bën të mundur koordinimin dhe drejtimin efikas të njësisë.	Përgatitja e Termave të Referencës për vlerësimin e qeverisjes dhe dakordësimi i tyre me Zyrën e Kryeministrit dhe MSHMS-në; Caktimi i konsulentëve për vlerësimin e menaxhimit; Kryerja e vlerësimit të menaxhimit; Marrja e masave bazuar në rezultatet e vlerësimit përpara përfundimit të afatit të këtij plani dhe përfshirja e tyre në PBA.	1

2.3.2.2 Raporti vjetor

Konteksti

Pas përftimit të të dhënave mbi treguesit në nivel BE-je dhe në nivel kombëtar, do të përmirësohen bazat e të dhënave për matjen, monitorimin dhe raportimin periodik të përfshirjes sociale në Shqipëri. Ky nivel në rritje i disponueshmërisë së të dhënave do të duhet të përmblidhet në një raport vjetor për përfshirjen sociale dhe varfërinë. Raporti nuk do të përqendrohet thjesht në anketat sasiore dhe të dhënat administrative, por do të ofrojë gjithashtu një përditësim të faktorëve cilësorë që kanë ndikim në përfshirjen sociale, të tilla si mjedisi makro-ekonomik, menaxhimi i financave publike dhe PBA-ja, organizimet në administratën publike, planet dhe strategjitë sektoriale, legjislacioni, anëtarësimi në BE, si dhe planet/veprimet e partnerëve për zhvillim.

Raporti vjetor i hartimit nën koordinimin e MSHMS-së me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Pas hartimit, raporti paraqitet pranë strukturës përkatëse të GMIP "Zhvillimi i kapitalit njerëzor", drejtuar nga ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nën të cilin përfshihet politika sociale dhe punësimi, sipas VKM-së nr. 30, datë 17.1.2024.

Tabela më poshtë jep informacion për objektivin, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Përgatitja dhe publikimi i raportit vjetor	Raport informues për përfshirjen sociale mbështetur në të dhëna sasiore dhe cilësore.	Hartimi i raporteve vjetore të përfshirjes sociale, duke filluar nga viti 2024. Raporti vjetor i përfshirjes sociale tregon përparim në zbatimin e Planit të Veprimit të DPPS-së.	Përgatitja e modelit të raportit vjetor të përfshirjes sociale; Caktimi i personave përgjegjës në MSHMS për koordinimin e hartimit të raportit dhe konsulentëve. **Paraqitja e draft-raportit pranë strukturës së IPMG-së dhe miratimi** Botimi i raportit vjetor në shqip dhe anglisht.	2

2.3.3 Shtylla C: Përmirësimi i dialogut mbi politikat

Konteksti i politikave

Ekziston një nivel relativisht i ulët i të kuptuarit të politikave publike të përfshirjes sociale, rëndësisë së saj strategjike për arritjet që duhet të realizojë Shqipëria në kuadër të agjendës së anëtarësimit në BE, si dhe ndikimit të saj në hartimin e politikave që përmirësojnë rritjen ekonomike dhe ulin varfërinë. Shpeshherë, ky term përdoret si përkufizim alternativ për "grupet në nevojë". Edhe pse këto grupe janë thelbësore për përkufizimin, fokusin dhe analizën e përfshirjes sociale, ato nuk janë grupet e vetme të popullsisë që mbulohen nga ky term. Për të trajtuar këtë keqkuptim dhe për të garantuar zbatimin e përfshirjes sociale në një gamë të gjerë të fushave të politikave dhe grupeve të popullsisë, qeveria do të miratojë masat në vijim:

- Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie komunikimi për përfshirjen sociale që merr në konsideratë nevojat e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor, të sektorit privat dhe të aktorëve të shoqërisë civile;

- Hartimi dhe zbatimi i anketave cilësore periodike/tematike për përfshirjen sociale në Shqipëri, të cilat fokusohen tek intensiteti, shkaqet dhe llojet e përjashtimit social;

- Nxitja e dialogut mbi politikat për përfshirjen sociale në Shqipëri përmes një kalendari aktivitetesh dhe një konference kombëtare të përvitshme për përfshirjen sociale.

2.3.3.1 Analiza cilësore e përfshirjes sociale

Konteksti

Në shkencat shoqërore pranohet gjerësisht rëndësia e përdorimit të një sërë metodash të ndryshme për vlerësimin e dukurive sociale dhe ekonomike. Për t'i kuptuar sa më mirë çështjet e përjashtimit social në Shqipëri dhe për të krijuar një themel të fortë mbi bazën e të cilit të nxirren rekomandime për politikat, janë të nevojshme të dhëna që shërbejnë për të kuptuar në mënyrë më të thellë dhe specifike një kontekst të caktuar.

Përfshirja sociale është një çështje komplekse që ka nevojë për integrimin koherent të qasjeve sasiore dhe cilësore. Për këtë arsye, analistët që merren me përfshirjen sociale duhet të nxiten të plotësojnë metodat sasiore me metoda cilësore që përkojnë më së miri me natyrën specifike të çështjeve që po studiohen[27]. Në përgjithësi, metodat cilësore u referohen një sërë teknikave të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, të cilat përdorin kampionë të qëllimshëm dhe intervista gjysmë të strukturuara dhe me pyetje të hapura. Këto teknika, të cilat prodhojnë dhe analizojnë të dhëna tekstuale, lejojnë kryerjen e një analize më të thelluar të proceseve sociale, politike dhe ekonomike. Përdorimi i analizave cilësore mbështetet në të dhënat unike dhe të rëndësishme që ato gjenerojnë dhe së dyti, në kapacitetin e tyre për të trajtuar dobësitë që shfaqen kur zbatohen vetëm qasjet sasiore. Për shembull, analizat cilësore të llojeve, objektit, thellësisë dhe intensitetit të përfshirjes sociale variojnë sipas veçorive të identitetit (si gjinia, mosha, përkatësia etnike, statusi i aftësisë së kufizuar), veçorive të vendbanimit (vendi i banimit, lloji i vendbanimit, tipografia, largësia, klima, burimet natyrore) dhe veçorive ekonomike (veprimtaritë ekonomike, infrastruktura, nivelet dhe llojet e investimeve, karakteristikat e ndërmarrjeve, prania apo mungesa e institucioneve arsimore dhe shëndetësore, karakteristikat e tregut të punës), veçorive të qeverisjes (prania apo mungesa e zbatimit të ligjit, nivelet e ndershmërisë dhe korrupsionit, aftësia reaguese e organeve publike në ofrimin e shërbimeve) dhe sipas veçorive shoqërore (aksesi në rrjetet sociale, prania e aktorëve të shoqërisë civile, mundësia e argëtimit, nivelet e besimit dhe solidaritetit, shkëmbimet pa para në dorë, konfliktet dhe bashkëpunimi). Tabela më poshtë jep informacion për objektivin specifik, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Kryerja dhe publikimi i analizave cilësore	Përmirësimi i një të kuptuari më të thelluar rreth përfshirjes sociale në Shqipëri.	Studim cilësor bazë për përfshirjen sociale në Shqipëri. Përpunimi i evidencave cilësore për llojet, shkaqet dhe intensitetin e përfshirjes sociale në Shqipëri.	Identifikimi i fushave të përfshirjes sociale, ku është përparësi kryerja e studimeve cilësore në Shqipëri; Përgatitja e një studimi cilësor bazë në nivel kombëtar për llojet, shkaqet dhe intensitetin e përjashtimit social në Shqipëri (2024–2025); Kryerja e të paktën 7 studimeve cilësore tematike për përjashtimin social gjatë periudhës 2024–2028; Përditësimi i studimit cilësor bazë në nivel kombëtar për llojet, shkaqet dhe intensitetin e përjashtimit social në Shqipëri (2028), në kuadër të përgatitjeve për një qasje të re për periudhën 2028–2032.	1

[27] Metodat sasiore të hulumtimit janë metodat në të cilat të dhënat mblidhen dhe analizohen në një formë më të standardizuar dhe shpesh numerike, si dhe lënë më pak vend për pyetje të hapura dhe gjetje të papritura. Shumë karakteristika individuale dhe të komuniteteve, ku përfshihen identitetet, perceptimet dhe bindjet, nuk mund të mblidhen në mënyrë kuptimplotë përmes vrojtimeve formale me pyetësorë. Ato nuk mund të kuptohen ashtu siç duhet pa iu referuar kontekstit të vendit ku jetojnë këta persona.

2.3.3.2 Konferenca vjetore

Konteksti

Konferenca Vjetore për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (KVPSSH) do të organizohet nga MSHMS-ja me synimin që të ndahen gjetjet e studimeve dhe risive të evidentuara gjatë 12 muajve të mëparshëm. Risitë e paraqitura do të ndihmojnë që analiza dhe raportimi mbi përfshirjen sociale të vendosen në rrugë më të qëndrueshme, dhe do të bëjnë të mundur që qeveria, sektori privat dhe aktorët e shoqërisë civile t'u përgjigjen më mirë nevojave të qytetarëve. Konferenca kombëtare do të ofrojë një platformë për të prezantuar raportin vjetor të përfshirjes sociale dhe do të ftohen folës kryesorë të nivelit të lartë. Konferenca do të theksojë masat që janë marrë për të forcuar drejtimin financiar dhe administratën publike, përmirësimet në sektorë të caktuar, masat e marra për uljen e rrezikut dhe të cenueshmërisë në komunitetet vendore, si dhe do të nxjerrë në pah të dhënat cilësore dhe sasiore për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri.

Pjesëmarrësit dhe prezantuesit në konferencë synohet të jenë nga një gamë e gjerë grupesh interesi në Shqipëri, përfshirë organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, sektori privat, sektori joqeveritar dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim. Perspektiva shqiptare do të plotësohet me paraqitje të praktikave, risive dhe ideve për trajtimin e çështjeve të përfshirjes sociale në shtetet anëtare të BE-së dhe në vende të tjera kandidate për anëtarësim në BE.

Konferenca do të mbështetet në parimin e partneritetit me bashkëfinancim (në fonde ose në natyrë) nga sektori privat. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Organizimi i konferencës vjetore	Nxitja e të nxënit dhe shkëmbimit të ideve për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri dhe në BE.	Cilësi më e mirë e dialogut mbi politikat për uljen e përjashtimit social dhe varfërisë në Shqipëri. Kuptimi më i mirë i rrezikut dhe cenueshmërisë nga përjashtimi social në Shqipëri. Paraqitja e raportit vjetor të përfshirjes sociale në konferencë.	Planifikimi paraprak i përmbajtjes dhe fokusit të KVPSSH-së; Identifikimi paraprak i folësve; Identifikimi i bashkë-sponsorizuesve tregtarë dhe nënshkrimi i marrëveshjes me ta; Identifikimi i folësve kryesorë.	1

2.3.3.3 Strategjia e komunikimit

Konteksti

DPPS-ja është një Mekanizëm që i mundëson Shqipërisë të përshtatë politikat e saj sektoriale për të miratuar, integruar dhe përshtatur qasjet e politikave të përfshirjes sociale në përputhje me kërkesat e procesit të integrimit në BE. Kjo kërkon një përditësim të politikave ekzistuese dhe miratimin e masave që do të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe të punës së qytetarëve, me fokus të veçantë te grupet në nevojë, duke garantuar që të gjithë të gëzojnë të mirat e rritjes ekonomike dhe të përmirësimit të konkurrencës. Ky ndryshim në qasje duhet t'u komunikohet qartë dhe në mënyrë koncize ministrive, institucioneve, agjencive dhe departamenteve qeveritare (MAD-ve), aktorëve të sektorit privat dhe organizatave dhe forumeve të shoqërisë civile. Strategjia e komunikimit duhet të sigurojë që grupe specifike të interesit, si dhe e tërë shoqëria shqiptare në përgjithësi, të jenë të informuara mbi synimin dhe qëllimin e DPPS-së dhe të veprimtarive të saj, të kuptojnë se pse është e nevojshme dhe çfarë përfitimesh do të sjellë, si dhe rrit besimin se produktet dhe rezultatet e DPPS-së janë të besueshme, me cilësi të lartë dhe ofrojnë informacion novator. Tabela më poshtë jep informacion për objektivat specifikë, treguesit e arritjeve dhe veprimet.

	Objektivat	Treguesit e arritjeve	Veprimet	Niveli i përparësisë
Hartimi i strategjisë së komunikimit	Përpjekjet e Shqipërisë për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale bëhen të njohura gjerësisht përmes një strategjie komunikimi efektive dhe efikase.	Prova të përdorimit të një analize të përmirësuar të përfshirjes sociale nga hartuesit shqiptarë të politikave. Prova se publiku ka një kuptim më të mirë të rëndësisë së matjes dhe monitorimit të përfshirjes sociale, si pjesë e përpjekjeve për të sjellë rritje ekonomike, për të përmirësuar konkurrencën dhe për të ulur varfërinë. Numri i artikujve në media për analizat e përfshirjes sociale. Numri i raporteve të BE-së që përmendin analizat e përfshirjes sociale në Shqipëri. Përdorimi i vlerësimit vjetor të strategjisë së komunikimit për të trajtuar dobësitë dhe për të modifikuar strategjinë.	Hartimi i një strategjie komunikimi që përfshin mediat elektronike dhe ato të shkruara; Përgatitja e literaturës përkatëse mbi përfshirjen sociale; Shpërndarja e DPPS-së; Organizimi i takimeve ku palët e përfshira do të kenë mundësi të japin mendime dhe vlerësime për të përcaktuar çfarë duhet të komunikohet, si dhe për kohën dhe nivelin e informacionit të komunikuar; Kryerja e një vlerësimi vjetor për të vlerësuar efektivitetin e strategjisë së komunikimit.	2

2.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Në Shqipëri tashmë ka një numër nismash për zhvillimin e kapaciteteve, të cilat janë thelbësore për përfshirjen sociale. Ato përfshijnë një gamë të gjerë veprimtarish dhe aftësish, si dhe ofrojnë një kombinim ndërhyrjesh të ndryshme si asistencë teknike, analiza dhe trajnime. Struktura e reformës së DPPS-së, me shtyllat dhe komponentët e saj, do të ndihmojë në harmonizimin e këtyre nismave në të ardhmen, si dhe do të nxisë nisma të tjera për të mbështetur reformën e përfshirjes sociale dhe reformën për uljen e varfërisë dhe për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë në të ardhmen aty ku nevojat janë më të mëdha. Këto vëzhgime vlejnë edhe për qeverinë, çka do të thotë se struktura e DPPS-së ofron një kuadër për kanalizimin e shpenzimeve kapitale dhe korente për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në PBA. Kalimi në një qasje sektoriale në sektorin e punësimit, aftësive dhe politikave sociale (PAPS), do të bëjë të mundur gjithashtu prioritizimin e komponentëve të ndryshëm të DPPS-së dhe përgatitjen e një qasjeje të detajuar për ndërtimin e kapaciteteve dhe për dialog me partnerët për zhvillim në këtë fushë të rëndësishme të politikave publike.

Ndonëse përgjegjësia kryesore për zbatimin e reformave për matjen, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes sociale i takon MSHMS-së, DPPS ka lidhje me të gjithë sektorin qeveritar. Për këtë arsye, përgjegjësia e përgjithshme për zbatimin me sukses të DPPS-së ndahet ndërmjet të gjithë këtyre aktorëve të sektorit publik.

Brenda MSHMS-së, po materializohen strukturat e GMIP-së për sektorin e punësimit dhe atë social, duke përfshirë edhe një kuadër që garanton vendin e përfshirjes sociale në qasjen sektoriale dhe pasqyrimin e plotë të saj në programet e ardhshme për mbështetjen e sektorit. Struktura Burimore Teknike (SBT) do të ketë një rol kyç në garantimin e zbatimit të shtyllave dhe komponentëve të kësaj DPPS-je.

2.5 Matrica e planit të veprimit për dokumentin e politikave të përfshirjes sociale

Shtyllat	Afati i zbatimit					Institucioni përgjegjës	Institucionet e përfshira	Buxheti (lek) (DPPS– 5 vjet)	Buxheti PBA (2024–2026)	Buxheti partnerët për zhvillim (2024–2026)	Hendeku në buxhet (2024–2026)
	2024	2025	2026	2027	2028						
Shtylla A - Sistemet e qëndrueshme për përfshirjen sociale								**57 900 000**	56 700 000	700 000	700 000
Veprimi 1: Përpunimi i treguesve statistikorë • Krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale (GNSPS); •Katër takime të organizuara çdo vit; •Hartimi dhe miratimi i standardeve, përkufizimeve, i burimeve të të dhënave dhe i treguesve për përfshirjen sociale; •Trajnimi i 100 nëpunësve të shtetit për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale.		X				Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave në Shqipëri	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, MEKI, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, dhe Ministria e Brendshme.	56 800 000 (paga/trajnime)	56 400 000 (paga)	400000 (trajnimet)	400000 (donatore/GOPO)
Veprimi 2: Përditësimi dhe botimi i fjalorit • Përditësimi dhe botimi i fjalorit.		X		X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale		300 000		300 000	300 000
Veprimi 3: Përpunimi i të dhënave administrative • Përpunimi i të dhënave administrative (sipas fushave të përgjegjësive secili institucion).		X	X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimet Sociale Shtetërore, Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, MEKI, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, dhe Ministria e Brendshme.	300 000 (paga)	300 000 (paga)		
Veprimi 4: Krijimi i Strukturës Burimore Teknike (2025) • Ngritja e një Mekanizmi për të nxitur dhe mbështetur dialogun politik për çështjet metodologjike që lidhen me anketën AANJ dhe burimet e tjera të të dhënave;		X	X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Strukturat e qeverisjes vendore dhe qendrore dhe aktorët e shoqërisë civile	500 000 (ekspertë, trajnime dhe faqja web)			500 000 (Donatorë)

• Ngritja e një Mekanizmi për të nxitur dhe mbështetur analizën dytësore të të dhënave nga anketa AANJ dhe burimet e tjera të të dhënave; • Krijimi i faqes së internetit për SBT-në; • Bërja funksionale e faqes së internetit të SBT-së.											
Shtylla B- Sistemet efektive për menaxhimin e përfshirjes sociale								**560 000**	520 000	400 000	400 000
Veprimi 1: Personel i angazhuar për menaxhimin dhe koordinimin e përfshirjes sociale • Përfshirja në përshkrimin e punës të menaxhimit dhe koordinimit të përfshirjes sociale; • Fuqizimi i kapaciteteve të personelit.			X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	520 000 (pagat)	520 000		
Veprimi 2: Përgatitja dhe publikimi i raporteve vjetore • Hartimi i katër raporteve për përfshirjen sociale në vitet 2024, 2025, 2026. 2028 dhe publikimi i tyre *online*.			X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministritë e linjës Struktura Burimore Teknike, MSHMS	400 000			400 000 Projekti për përfshirjen sociale, BE)
Shtylla C- Përmirësimi i dialogut mbi politikat								**900 000**			900000
Veprimi 1: Kryerja dhe publikimi i analizës së cilësisë • Kryerja në vitin 2024 e një studimi kombëtar bazë cilësor për përfshirjen sociale në Shqipëri; • Katër studime tematike për përfshirjen sociale; • Kryerja e një studimi kombëtar cilësor në vitin 2028.		X	X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministritë e linjës dhe organizatat e shoqërisë civile	200 000			200 000 (donatorë) Projekti për përfshirjen sociale, BE)
Veprimi 2: Organizimi i konferencave vjetore •Organizimi i katër konferencave vjetore; • Minimumi 100 pjesëmarrës për konferencë; • Publikimi i gjetjeve nga konferenca.		X	X	X	X	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Zyra e Kryeministrit, ministritë e linjës	400 000			400 000 (Donatorë/ Projekti për përfshirjen sociale, BE)

Veprimi 3: Hartimi i strategjisë së komunikimit •Hartimi dhe publikimi i një strategjie komunikimi; •Përfshirja e analizave për përfshirjen sociale në të paktën 15 politika dhe dokumente të qeverisë; •Të paktën 6 video të shkurtra të përfshirjes sociale në masmedia dhe në internet; •Njëzet raporte në vit të masmedias për përfshirjen sociale.						Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	300 000			300 000 (donatore/
Nëntotali për të gjitha shtyllat								**59 360 000**			
Totali i përgjithshëm i shpenzimeve të parashikuara								**59 360 000**			
Buxheti kombëtar i qeverisë shqiptare								57 320 000			
Kontributet e Partnerëve për Zhvillim								**2 000 000**			

4. BURIMET FINANCIARE DHE ALOKIMI I BUXHETIT (në 000 lek)

Shtyllat	2024	2025	2026	2027	2028
Shtylla A **Sisteme të qëndrueshme për përfshirjen sociale**					
Veprimi 1: Treguesit statistikorë	11480	11480	11280	11280	11280
Veprimi 2: Fjalori tematik	-	-	300		-
Veprimi 3: Të dhënat administrative 300000	60	60	60	60	60
Veprimi 4: Struktura Burimore Teknike	10	10	10	10	10
Shtylla B **Sisteme efektive për menaxhimin e përfshirjes sociale**					
Veprimi 1: Njësia e brendshme për menaxhimin dhe koordinimin e përfshirjes sociale 520	104	104	104	104	104
Veprimi 2: Raporti vjetor	-	100	100	100	100
Shtylla C **Përmirësimi i dialogut mbi politikat**					
Veprimi 1: Analiza cilësore	40	40	40	40	40
Veprimi 2: Konferenca vjetore	-	100	100	100	100
Veprimi 3: Strategjia e komunikimit	60	60	60	60	60
Nëntotali për të gjitha shtyllat	16	271,5	270	271,5	270
Totali i përgjithshëm i shpenzimeve të parashikuara	16	271,5	270	271,5	270
Buxheti kombëtar i qeverisë shqiptare	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Kontributet e Partnerëve për Zhvillim	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**

5. MATJA DHE MONITORIMI I PËRFSHIRJES SOCIALE DHE VARFËRISË NË SHQIPËRI

5.1 Vështrim i përgjithshëm

Treguesit e pasqyruar në këtë kapitull krijojnë bazën për përmirësimin e matjes, monitorimit dhe raportimit të përfshirjes sociale në Shqipëri.

Metodologjia e matjes dhe monitorimit është hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojë krahasueshmërinë e treguesve kyçë të përfshirjes sociale në Shqipëri me situatën në shtetet anëtare të BE-së dhe në shtetet në proces anëtarësimi në BE, si dhe që të garantojë informacione mbi specifikat e problemit të përfshirjes sociale në Shqipëri. Standardizimi i matjes së përfshirjes sociale dhe varfërisë në Shqipëri do të bëjë të mundur përafrimin dhe harmonizimin me dokumentet e ndryshme strategjike që rregullojnë këtë fushë në BE. Aktualisht, burimet kryesore të të dhënave për llogaritjen e treguesve të varfërisë dhe të përfshirjes sociale janë Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (ESSPROS) dhe Anketa e Forcave të Punës (AFP). Po kështu, përdoren të dhëna edhe nga Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) dhe statistika jetësore për arsimin që mblidhen nga Instituti i Statistikave (si p.sh. Burra dhe Gra) dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, të dhëna për shëndetin që mblidhen nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), si dhe të dhëna për punësimin dhe aftësitë që mblidhen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Të dhënat për aksesin në drejtësi mblidhen nga Ministria e Drejtësisë dhe nga institucionet në varësi të saj. Të dhënat për strehimin mblidhen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe nga Enti Kombëtar i Banesave. Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mat nivelin e jetesës, varfërinë relative dhe deprivimi material në familjet shqiptare. ABF paraqet të dhëna mbi strukturën e shpenzimeve për konsum të familjeve shqiptare, AFP mbledh informacionin cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të gjithë individët 15 vjeç e lart në Shqipëri, ndërsa ESSPROS mat nivelin e përfitimeve sociale në skemat e mbrojtjes sociale sipas tetë funksioneve bazë të mbrojtjes sociale: sëmundje/kujdes shëndetësor, pleqëri, mbijetesë, aftësi të kufizuara, familje/fëmijë, papunësi, strehim social, përjashtim social.

Duke mos qenë shtet anëtar i BE-së, Shqipëria nuk është e detyruar të realizojë rregullisht anketat e mësipërme. Megjithatë, që nga viti 2017, INSTAT-i vazhdon të realizojë çdo vit AANJ-në dhe në vitin 2019 filloi edhe zbatimin e sistemit ESSPROS. Anketa e Buxhetit të Familjes u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-

2007, 2008-2009 dhe që nga viti 2014 është realizuar në mënyrë të vazhdueshme. Për sa i përket AFP-së, Anketa e Forcave të Punës në Shqipëri është kryer nga INSTAT-i që nga viti 2007.

5.2 Vështrim i përgjithshëm mbi treguesit e varfërisë

Rezultatet e AANJ-së paraqesin statistika të krahasueshme me vendet e tjera, si dhe sigurojnë të dhëna të besueshme në fushën e varfërisë relative, përjashtimit social dhe të ardhurave familjare, me bazë vjetore dhe jo vetëm. Anketa AANJ është anketë panel dhe mbulon të gjitha familjet (Njësitë Ekonomike Familjare) e territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga madhësia e tyre ose karakteristikat socio-ekonomike. Niveli i disagregimit të të dhënave të kësaj ankete shkon me shpërndarjen sipas gjinisë, grup-moshës, nivelit arsimor, tipologjisë së familjes, ndarjes sipas rajoneve etj. INSTAT-i po zbaton anketën EU-SILC që prej 2017. Kjo anketë mbulon të gjitha familjet e territorit të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga madhësia apo karakteristikat e tyre socio-ekonomike.

Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, kufiri i rrezikut për të qenë i varfër llogaritet në bazë të konceptit relativ (i varfër në raport me të tjerët) dhe përcaktohet në 60% të medianës së të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara të familjes duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të modifikuar të OECD-së. Të ardhurat totale të disponueshme të ekuivalentuara të familjes (NjEF) konsiderohen të ardhurat totale neto (të ardhurat pas taksave dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore) të marra nga të gjithë anëtarët e familjes (NJEF). Deprivimi material tregon nivelin e jetesës së popullsisë nga shkalla e deprivimit material. Persona thellësisht të privuar materialisht janë ata që jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë financiarisht të paktën katër nga nëntë kategoritë e privimit material që lidhen me asetet, kushtet e jetesës apo aspektet financiare. [28]

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) shërben si bazë për monitorimin, analizimin dhe raportimin e përfshirjes sociale, por treguesit e nivelit të jetesës për grupet sociale në nevojë (romët, egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara) do të mungojnë për shkak të kufizimeve metodologjike që nuk bëjnë të mundur nxjerrjen e të dhënave për grupe të tilla sociale. Edhe statistikat evropiane përballen me të njëjtin kufizim dhe për këtë arsye, në vend të tyre do të duhet të përdoren anketa të hartuara posaçërisht për këtë qëllim. Për rrjedhojë, do të jetë veçanërisht e rëndësishme që të ketë udhëzime të qarta për zbatimin e anketave të tjera cilësore, me qëllim që të përftohet një ide sa më e qartë mbi treguesit specifikë të përfshirjes sociale dhe një përkufizim shtesë mbi sistemin e monitorimit të treguesve specifikë në vend.

Politikëbërësit në Shqipëri duhet të informohen dhe ndërgjegjësohen për lidhjen e treguesve me politikat. Në këtë këndvështrim duhet të jenë të ndërgjegjësuar për treguesit që dalin nga anketa AANJ, si **shkalla e rrezikut për të qenë i varfër,** që është përqindja e personave që jetojnë në familje me të ardhura të disponueshme të ekuivalentuara [29] (pas transfertave sociale) nën **pragun e rrezikut të varfërisë**, i cili është përcaktuar në 60% të medianës së të ardhurave mesatare kombëtare të disponueshme të ekuivalentuara, pas transfertave sociale[30].

Të **ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara** janë të ardhurat e përgjithshme të një familjeje, pas zbritjes së taksave dhe zbritjeve të tjera, të disponueshme për t'u shpenzuar apo kursyer, pjesëtuar me numrin e anëtarëve të familjes të konvertuar në të rritur të ekuivalentuar; anëtarët e

[28] Kategoritë e deprivimit material përfshijnë për shembull pamundësinë për të pasur një TV, makinë larëse, makinë, apo për të përballuar shpenzimet për një javë pushimi vjetor larg shtëpisë.

[29] Të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara llogariten në tri faza: mblidhen të gjitha të ardhurat monetare të përftuara nga çfarëdo lloj burimi nga çdo anëtar i familjes; këtu përfshihen të ardhurat nga puna, investimet dhe pensionet sociale, plus çdo e ardhur tjetër familjare; nga kjo shumë zbriten taksat dhe kontributet shoqërore që janë paguar në mënyrë që të pasqyrohen dallimet në madhësinë dhe përbërjen e familjes; totali (neto) i të ardhurave familjare pjesëtohet me numrin e 'të rriturve të ekuivalentuar', duke përdorur një shkallë (ekuivalence) standarde: shkalla e modifikuar e OECD-së. Kjo shkallë i jep peshë të caktuar specifike të gjithë anëtarëve të familjes; këto pastaj mblidhen për të arritur në një **madhësi të ekuivalentuar të familjes**. Shifra që përftohet quhet e ardhur e disponueshme e ekuivalentuar që i atribuohet në mënyrë të barabartë çdo anëtari të familjes. Për treguesit e varfërisë, të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara llogariten nga të ardhurat e disponueshme totale të secilës familje pjesëtuar me madhësinë e ekuivalentuar të familjes.

[30] Shihni http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:At-risk-of-poverty_rate

familjes ekuivalentohen ose bëhen të barasvlershëm duke e ponderuar secilin sipas moshës përmes asaj që quhet *shkalla e ekuivalentimit e OECD*-së, e cila i cakton një peshë specifike çdo anëtari të familjes. Më pas, këto mblidhen për të përftuar **madhësinë e ekuivalentuar të familjes**: 1,0 pikë për të rriturin e parë 14 vjeç e lart; 0,5 për të dytin dhe për çdo person tjetër 14 vjeç e lart; 0,3 pikë për çdo fëmijë nën 14 vjeç.

Në AANJ, **shkalla e rrezikut për të qenë i varfër përpara përfitimeve sociale,** llogaritet si përqindja e personave me të ardhura të disponueshme të ekuivalentuara përpara transfertave sociale, nën kufirin e rrezikut për të qenë i varfër. Lidhur me përfitimet sociale, rreziku për të qenë i varfër analizohet duke marrë për bazë 2 kategori përfitimesh sociale. Kategoria e parë ka të bëjë me vlerësimin e rrezikut për të qenë i varfër bazuar në të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara përpara përfitimeve sociale, ku pensionet e pleqërisë dhe ato familjare janë pjesë e përfitimeve sociale. Kategoria e dytë ka të bëjë me vlerësimin e rrezikut për të qenë i varfër bazuar në të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara përpara përfitimeve sociale, ku pensionet e pleqërisë dhe ato familjare nuk janë pjesë e përfitimeve sociale. Vlerësime të tilla tregojnë ndikimin e përfitimeve sociale në të ardhurat e disponueshme të familjeve dhe në uljen e rrezikut për të qenë i varfër.

Shkalla e rrezikut të vazhdueshëm të varfërisë tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje të cilat, në vitin aktual, si dhe në të paktën dy nga tre vitet e mëparshme, kanë pasur të ardhura të disponueshme të ekuivalentuara nën pragun e rrezikut të varfërisë. Për llogaritjen e kësaj shifre, metodologjia e përdorur nga AANJ-ja si një anketë panel studion dhe analizon të dhëna për një periudhë afatgjatë, që kanë të bëjnë me ndryshimet në nivel individual përgjatë kohës, të vërejtura periodikisht gjatë një periudhe katërvjeçare.

Kundërshtimi më i zakonshëm[31] ndaj përdorimit të treguesve për vlerësimin e *shkallës së rrezikut të varfërisë* është se ajo mat pabarazinë dhe jo varfërinë, sepse është e ndjeshme ndaj pabarazive në të ardhura dhe krejtësisht e pandjeshme ndaj nivelit të të ardhurave. Kështu, në vendet me të ardhura të larta, rreziku nga varfëria mund të jetë i barabartë apo madje edhe më i lartë se sa në vendet me të ardhura më të ulta dhe shifrat absolute dhe përqindja e personave të pafavorizuar mund të vazhdojë të rritet pavarësisht zhvillimit ekonomik dhe anasjelltas, rreziku nga varfëria mund të mos rritet pavarësisht të ardhurave më të ulëta. Në kohë krizash, të ardhurat e fituara janë zakonisht të parat që pësojnë ulje, çka ndikon në shpërndarjen e të ardhurave dhe në medianën e të ardhurave, si dhe çon në uljen e pragut të varfërisë. Në situata të tilla, individët që gjendeshin pak nën nivelin e pragut, mund të dalin sipër tij, pavarësisht nga fakti që gjendja e tyre e vërtetë në fakt është përkeqësuar. Në kushte të tilla, sipas shkallës së rrezikut nga varfëria, përqindja e popullatës së rrezikuar do të pakësohet.[32]

Për të përftuar informacione më gjithëpërfshirëse rreth tendencave të varfërisë në Shqipëri, varfëria duhet të monitorohet dhe të paraqitet sipas përkufizimeve dhe metodologjive të ndryshme, dhe jo vetëm mbi bazën e metodologjisë së AANJ-së. Ndaj, ndonëse është shumë e rëndësishme që Shqipëria të përdorë metodologjinë e BE-së për matjen e *rrezikut nga varfëria,* është po aq e rëndësishme që të monitorohet gjendja e varfërisë absolute (**e matur mbi bazën e konsumit, sipas përkufizimit të tij në AMNJ**). Përdorimi i më shumë se sa një qasjeje përputhet me rekomandimet e Eurostat, i cili shprehet se për të vlerësuar standardet e jetesës, krahas të ardhurave, duhet të përdoren edhe matje të tjera, si konsumi.[33] Monitorimi i varfërisë absolute ka rëndësi jo vetëm për të monitoruar ecurinë në numrin e personave të varfër, por edhe për zhvillimin e politikave të cilat synojnë uljen e varfërisë së grupeve që nuk janë në

[31] Rava llion. M. (prill 2010). Poverty Lines across the World (Kufijtë e varfërisë në mbarë botën). *Dokumente pune për studimin e politikave,* nr. 5284, Uashington DC.

[32] Eurostat (2013a) Statistical matching of EU-SILC and the Household Budget Survey to compare poverty estimates using income, expenditures and material deprivation (Përputhja statistikore ndërmjet BE-AANJ dhe Anketës së Buxhetit të Familjeve me qëllim krahasimin e vlerësimeve të varfërisë duke përdorur të ardhurat, shpenzimet dhe privimin material). *Eurostat Methodologies and Working papers (Metodologjitë dhe dokumentet e punës së Eurostat).*

[33] Eurostat. (2013b). The measurement of poverty and social inclusion in the EU: achievements and further improvements (Matja e varfërisë dhe përfshirjes sociale në BE: Arritjet dhe përmirësime të mëtejshme), Dokument pune nr. 25, 25 nëntor 2013, paraqitur në Konferencën e UNCEC-it, Gjenevë 2–4 dhjetor 2013.

gjendje të plotësojnë nevojat minimale për ushqim dhe shpenzime të tjera.

Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale, ESSPROS, që po zbatohet nga INSTAT-i, do të sigurojë një krahasim koherent me vendet e tjera evropiane, në lidhje me përfitimet sociale të familjeve dhe financimin e tyre.

ESSPROS-i përfshin tërësinë e politikave dhe programeve sociale që realizojnë organet shtetërore dhe private të cilat kanë si synim zvogëlimin e pasojave të varfërisë dhe përjashtimit social në familjet dhe individët që janë më në rrezik për aksesin dhe sigurimin e një sërë nevojave dhe funksioneve të domosdoshme ekonomike dhe sociale. Këto ndërhyrje që bëjnë organet publike dhe private në drejtim të mbrojtjes sociale përfshijnë mbështetjen financiare në formën e pagesave në para kesh, shërbimet në formën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra nga personat e mbrojtur, si dhe shërbimet në formën e mallrave që u ofrohen drejtpërsëdrejti njerëzve të mbrojtur.

Rreziqet ose nevojat e mbrojtjes sociale i referohen funksioneve të ESSPROS që janë gjithëpërfshirëse, si aftësia e kufizuar, sëmundja / kujdesi shëndetësor, pleqëria, të mbijetuarit, familja/ fëmijët, papunësia, strehimi dhe përjashtimi social. Ato nuk përfshijnë arsimimin, përveç nëse është një mbështetje për familjet e varfra me fëmijë.

ESSPROS bazohet kryesisht në të dhëna administrative ku sigurimi i përfitimeve sociale realizohet përmes skemave të mbrojtjes sociale të cilat përkufizohen si një grup i veçantë i rregullave, mbështetur nga një ose më shumë njësi institucionale, që rregullojnë ofrimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe financimin e tyre.

Sistemi ESSPROS përbëhet nga sistemi bazë dhe nga module specifike. Sistemi bazë paraqet të dhënat për përfitimet e ofruara dhe financimin e tyre, si shpenzimet dhe të ardhurat nga njësitë që janë përgjegjëse për sigurimin e këtyre përfitimeve. Modulet përmbajnë informacion plotësues statistikor mbi aspekte të veçanta të mbrojtjes sociale (Moduli i përfituesve të pensioneve; Moduli i përfitimeve nga papunësia; Moduli neto i përfitimeve sociale). Secili modul ka metodologjinë e tij dhe bazohet në një rregullore të veçantë të Komisionit Evropian.

INSTAT-i ka zbatuar sistemin bazë të ESSPROS dhe modulin mbi përfituesit e pensioneve, duke prodhuar grupin e parë të të dhënave 2018–2020. Janë identifikuar 28 skema të mbrojtjes sociale dhe përfitimet e detajuara brenda çdo skeme janë klasifikuar sipas tetë funksioneve të tij. Për çdo skemë dhe në totalin e skemave janë evidentuar të ardhurat, shpenzimet dhe përfitimet sociale të klasifikuara sipas funksioneve dhe karakteristikave të tjera që kërkon metodologjia e ESSPROS.

TREGUESIT PËR VARFËRINË DHE MBROJTJEN SOCIALE

1.VARFËRIA DHE MBROJTJA SOCIALE		
Treguesit e BE-së për përjashtimin social	**Përkufizimi**	**Burimi i të dhënave**
- Treguesit parësorë		
1. Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas gjinisë dhe grup-moshës	Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme ekuivalente janë nën kufirin e rrezikut të varfërisë të 60% të medianës së të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara mesatare kombëtare bazuar në shkallën e OECD-së (pesha 1 caktohet për të rriturin e parë, pesha 0,5 për të rriturit e tjerë mbi moshën 14 vjeç dhe pesha 0,3 për çdo fëmijë të moshës nën 14 vjeç).	AANJ[34]
1a. Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas tipit të familjes	Shkalla e rrezikut nga varfëria sipas tipit të familjeve, në varësi të madhësisë së familjes, numrit të të rriturve dhe numrit të fëmijëve në ngarkim.	AANJ

[34] Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, INSTAT.

1b. Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas intensitetit të punës së anëtarëve të familjes	Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas intensitetit të punës së anëtarëve të familjes i referohet numrit të muajve që kanë punuar të gjithë anëtarët e familjes në moshë pune gjatë vitit të të ardhurave të referuara, si përqindje e totalit të numrit të muajve në të cilët mund të ishte punuar teorikisht në familje.	AANJ
1c. Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas statusit të punës më të shpeshtë në tregun e punës	Statusi i veprimtarisë më të shpeshtë i anëtarëve të familjes me moshë 16+. Bazuar në statusin e veprimtarisë më të shpeshtë në vitin pararendës (statusi i veprimtarisë ekonomike që ka zgjatur gjashtë muaj ose më shumë), individët klasifikohen si ekonomikisht aktivë (të punësuar, të vetëpunësuar, ose punëkërkues të papunë) dhe ekonomikisht joaktivë (pensionistë dhe persona të tjerë joaktivë).	AANJ
1d. Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas statusit të akomodimit/banimit	Shkalla e rrezikut të varfërisë sipas statusit të akomodimit/banimit. Statusi i akomodimit/ banimit përcaktohet në a) pronar (ose pa qira); dhe b) qiramarrës me qiranë e tregut mbizotërues ose me tarifë të reduktuar.	AANJ
2. Kufiri i rrezikut të varfërisë	Pragu i rrezikut të varfërisë përfaqëson të ardhurat vjetore më të ulëta të disponueshme kur një person nuk do të konsiderohej në prag të varfërisë. Pragu i rrezikut të varfërisë përcaktohet si 60% e të ardhurave mesatare të disponueshme të ekuivalentuara për të gjitha familjet në një popullatë. Ky tregues shprehet në SFB (Standardi i Fuqisë Blerëse), në euro dhe monedhën kombëtare. Kufiri i rrezikut të varfërisë duhet të monitorohet për të gjithë popullsinë, për familjet me një person, familjet me dy të rritur dhe dy fëmijë.	AANJ
3. Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave, raporti i kuintileve S80/S20	Shkalla kuintile S80/S20 krahason të ardhurat totale të ekuivalentuara të kuintilit më të lartë dhe atij më të ulët. Kuintili më i lartë përfaqëson 20% të popullatës me të ardhurat e ekuivalentuara më të larta, ndërsa kuintili më i ulët është 20 përqindëshi i popullatës me të ardhura më të ulëta. Ajo mat vetëm dallimet ndërmjet kuintilit më të lartë dhe atij më të ulët të të ardhurave të ekuivalentuara.	AANJ
4. Hendeku relativ i rrezikut të varfërisë	Hendeku i varfërisë matet si diferenca midis të ardhurave mediane të disponueshme të ekuivalentuara të personave nën pragun e rrezikut të varfërisë dhe pragut të rrezikut të varfërisë, i shprehur si përqindje e pragut të rrezikut të varfërisë (pika e ndarjes: 60% e të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara mediane kombëtare).	AANJ
- Treguesit dytësorë		
5. Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave – Koeficienti Gini	Masa e pabarazisë në të ardhura, duke marrë parasysh të gjithë shpërndarjen e të ardhurave. Koeficienti Gini mat pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave bazuar në të ardhurat ekuivalente të disponueshme ku 0% shpreh barazinë e plotë dhe të gjithë personat disponojnë të njëjtin nivel të ardhurash,	AANJ

	ndërsa një koeficient Gini prej 100% shpreh pabarazinë e plotë ku vetëm një person disponon të gjitha të ardhurat.	
6. Shkalla e rrezikut të vazhdueshëm të varfërisë (50% e mesatares)	Përqindja e individëve kundrejt totalit të popullatës, të ardhurat ekuivalente të disponueshme të të cilëve ishin nën pragun e rrezikut të varfërisë për vitin aktual dhe të paktën 2 nga 3 vitet e mëparshme (kushti: ekzistenca e panelit të të dhënave).	AANJ
7. Varfëria në punë (me kohë të plotë/të pjesshme)	Përqindja e individëve të klasifikuar si të punësuar dhe që rrezikohen nga varfëria.	AANJ
TREGUESIT KOMBËTARË		
1. Përqindja e transfertave sociale	Masa e alokimit të transfertave sociale në popullatë dhe përqindja e transfertave sociale në të ardhurat e të varfërve dhe jo të varfërve.	AANJ
2a. Efikasiteti i transfertave sociale	Krahasimi i shkallëve të rrezikut të varfërisë përpara dhe pas transfertave sociale. Treguesi i përkufizuar në këtë mënyrë bën të mundur matjen e uljes së shkallës së rrezikut të varfërisë si rrjedhojë e transfertave sociale. Metoda e dytë për matjen e efikasitetit të transfertave sociale është matja e përqindjeve të transfertave sociale që i shpërndahen popullatës në rrezik të varfërisë.	AANJ
2b. Efektiviteti i transfertave sociale	Përqindja e hendekut relativ të rrezikut të varfërisë që eliminohet nga transfertat sociale. Tregon masën e alokimit të transfertave sociale sipas nivelit të të ardhurave të familjes dhe rrjedhimisht, mbështet hartimin e ndërhyrjeve në fushën e targetimit të transfertave sociale.	AANJ
3. Buxheti për mbrojtjen sociale	Buxheti i MSHMS-së i alokuar për mbrojtjen sociale	SHSSH[35]
4. Shpenzimet e ndihmës ekonomike dhe të asistencës sociale	Shpenzimet për programin e ndihmës ekonomike dhe programin e asistencës sociale	SHSSH
5. Numri i përfituesve: shërbime rezidenciale	Numri i individëve me disagregimet sipas gjinisë, grup-moshës, aftësisë së kufizuar, dhe përkatësisë etnike, që përfitojnë nga shërbimet rezidenciale	SHSSH
6. Numri i përfituesve: shërbime ditore	Numri i individëve me disagregimet sipas gjinisë, grup-moshës, aftësisë së kufizuar, dhe përkatësisë etnike, që përfitojnë nga shërbimet ditore	SHSSH
7. Numri i përfituesve: Komuniteti rom	Numri i përfituesve nga komuniteti rom	SHSSH
8. Fëmijët nën kujdestari	Numri i fëmijëve nën kujdestari	SHSSH
9. Viktimat e dhunës në familje	Numri i viktimave të dhunës në familje i regjistruar nga Shërbimi Social Shtetëror, me disagregimet sipas gjinisë, grup-moshës, aftësisë së kufizuar, dhe përkatësisë etnike	SHSSH
10. Viktimat e trafikimit	Numri i viktimave të trafikimit i regjistruar nga Shërbimi Social Shtetëror, me disagregimet sipas gjinisë, grup-moshës, aftësisë së kufizuar, dhe përkatësisë etnike	INSTAT/SHSSH MD
11. Martesat e hershme	Numri i martesave nën moshën 18 vjeç për vajzat dhe djemtë	INSTAT/SHSSH

[35] Shërbimi Social Shtetëror.

12. Kujdesi alternativ për fëmijët 0-17 vjeç	Numri i fëmijëve në përkujdesje alternative dhe normat për 100 mijë fëmijë të grup-moshës 0–17 vjeç në qendra rezidenciale (publike dhe private)	INSTAT
13. Pensione në skemën e sigurimeve shoqërore.	Numri i pensioneve (pleqërie, invaliditeti, familjar) për 1000 banorë sipas qarqeve	INSTAT
14. Pensione sociale	Përfitues dhe shpenzime për pensionet sociale	INSTAT
15. Masa e pensionit mesatar mujor sipas llojit	Masa e pensionit mesatar mujor sipas llojit	INSTAT
16. Persona në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike	Persona në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike sipas kategorive	INSTAT
17. Numri mesatar i përfituesve të pagesës së paaftësisë sipas llojit të paaftësisë	Numri mesatar i përfituesve të pagesës së paaftësisë (në % sipas llojit të paaftësisë)	SHSSH
18. Institucione publike dhe private të përkujdesjes shoqërore	Numri mesatar i institucioneve publike dhe private të përkujdesjes shoqërore	SHSSH
19. Përfituesit në institucionet publike dhe private të përkujdesjes shoqërore	Numri mesatar i përfituesve në institucionet publike dhe private të përkujdesjes shoqërore	SHSSH

SISTEMI I INTEGRUAR EVROPIAN PËR MBROJTJEN SOCIALE		
Treguesit e mbrojtjes sociale BE	**Përkufizime**	**Burimi i të dhënave**
Përfitime sociale sipas funksioneve		
Sëmundja/kujdesi shëndetësor	Mbajtja e nivelit të të ardhurave dhe mbështetja me para për sëmundje fizike ose mendore, duke përjashtuar aftësinë e kufizuar. Kujdesi shëndetësor që ka për qëllim ruajtjen ose përmirësimin e shëndetit të njerëzve të mbrojtur pa marrë parasysh origjinën e çrregullimit shëndetësor.	ESSPROS
Paaftësia	Mbajtja e nivelit të të ardhurave dhe mbështetja me para ose në natyrë (përveç kujdesit shëndetësor) për paaftësinë e personave me aftësi të kufizuara fizike ose mendore për t'u angazhuar në aktivitete ekonomike dhe sociale.	ESSPROS
Pleqëria	Mbajtja e nivelit të të ardhurave dhe mbështetja me para ose në natyrë (përveç përkujdesjes shëndetësore) për pleqërinë.	ESSPROS
Mbijetesa	Mbajtja e nivelit të të ardhurave dhe mbështetja me para ose në natyrë për vdekjen e një anëtari të familjes.	ESSPROS
Familja/fëmijët	Mbështetja me të ardhura ose në natyrë (përveç kujdesit shëndetësor) për shpenzimet e shtatzënisë, lindjes dhe adoptimit, rritjes së fëmijëve dhe përkujdesjes për anëtarët e tjerë të familjes.	ESSPROS
Papunësia	Mbajtja e nivelit të të ardhurave dhe mbështetja me para ose në natyrë për papunësinë.	ESSPROS
Strehimi social	Ndihma në lidhje me koston e strehimit.	ESSPROS
Përjashtimi social	Përfitime në para ose në natyrë (përveç kujdesit shëndetësor) të destinuara posaçërisht për të luftuar përjashtimin social, kur ato nuk mbulohen nga një prej funksioneve tjera.	ESSPROS
Përfitime sociale sipas karakteristikave		
Përfitime të pakushtëzuara	Përfitime sociale të cilat nuk kushtëzohen nga të ardhurat e përfituesit.	ESSPROS
Përfitime të kushtëzuara	Përfitime sociale të cilat janë të kushtëzuara - në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë - nga të ardhurat dhe/ose pasuria e përfituesit, të cilat bien nën një nivel të caktuar.	ESSPROS
Përfitime sociale sipas llojit		
Përfitime në para	Përfitimet në para mund të jenë periodike dhe të menjëhershme. Përfitime periodike janë përfitime në para kesh që paguhen në intervale të rregullta, si p.sh. çdo javë, muaj ose tremujor. Përfitime të menjëhershme janë përfitime në para kesh që paguhen vetëm një herë në formën e një shume të përgjithshme.	ESSPROS

Përfitime në natyrë	Përfitimet në natyrë janë përfitimet e dhëna në formën e mallrave dhe shërbimeve. Ato mund të ofrohen me anë të rimbursimit ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Rimbursimet janë përfitime në formë të pagesave që rimbursojnë marrësin në tërësi ose pjesërisht për shpenzimet e certifikuara/vërtetuara për mallra dhe shërbime të specifikuara. Përfitimet e ofruara në mënyrë të drejtpërdrejtë janë mallra dhe shërbime që jepen pa ndonjë parapagim nga përfituesi.	ESSPROS
Shpenzime për mbrojtjen sociale si përqindje ndaj PBB-së	Shpenzimet e mbrojtjes sociale në % ndaj PBB-së.	ESSPROS
Shpenzime për mbrojtjen sociale si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve qeveritare	Shpenzimet e mbrojtjes sociale në % ndaj totalit të shpenzimeve qeveritare.	ESSPROS
Pesha në përqindje e mbrojtjes sociale sipas funksioneve ndaj PBB-së		ESSPROS
Sëmundja/kujdesi shëndetësor	Përqindja e përfitimeve sociale për sëmundje/kujdes shëndetësor ndaj PBB-së.	ESSPROS
Paaftësia	Përqindja e përfitimeve sociale për paaftësinë ndaj PBB-së.	ESSPROS
Pleqëria	Përqindja e përfitimeve sociale për pleqërinë ndaj PBB-së.	ESSPROS
Mbijetesa	Përqindja e përfitimeve sociale për mbijetesën ndaj PBB-së.	ESSPROS
Familja/fëmijët	Përqindja e përfitimeve sociale për familjen/fëmijët ndaj PBB-së.	ESSPROS
Papunësia	Përqindja e përfitimeve sociale për papunësinë ndaj PBB-së.	ESSPROS
Strehimi social	Përqindja e përfitimeve sociale për strehimin social ndaj PBB-së.	ESSPROS
Përjashtimi social që nuk klasifikohet diku tjetër	Përqindja e përfitimeve sociale për përjashtimin social ndaj PBB-së.	ESSPROS
Të ardhura në fushën e mbrojtjes sociale		ESSPROS
Kontributet shoqërore	Kontributet shoqërore nënkuptojnë shpenzimet e bëra nga punëdhënësit në emër të punonjësve të tyre ose nga personat e mbrojtur për të siguruar të drejtën e përfitimeve sociale.	ESSPROS
Kontributet e përgjithshme të qeverisë	Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë për menaxhimin e skemave jo kontributive të kontrolluara nga qeveria dhe mbështetja financiare e ofruar nga qeveria për skemat e tjera të mbrojtjes sociale.	ESSPROS
Transfertat nga skema të tjera	Transferta nga skema tjera nënkupton pagesa të njëanshme (pakthyeshme) të marra nga skema tjera të mbrojtjes sociale.	
Te ardhura të tjera	Arkëtime, të ardhura të tjera nënkupton arkëtime të ndryshme rrjedhëse të skemave të mbrojtjes sociale. Ato ndahen në arkëtime nga të ardhurat nga prona dhe arkëtime të tjera.	ESSPROS
Moduli i përfituesve të pensioneve		
Përfitues të pensioneve në funksionin Aftësia e kufizuar	Këtu përfshihen: Përfituesit e pensionit të invaliditetit; dhe Përfituesit që marrin pension të parakohshëm për shkak të zvogëlimit të aftësisë për punë.	ESSPROS
Përfitues të pensioneve në funksionin Pleqëria	Përfituesit e pensionit të pleqërisë; Përfituesit e pensionit të parakohshëm të pleqërisë; Përfituesit e pensionit të pjesshëm.	ESSPROS
Përfitues të pensionit në funksionin e të mbijetuarve	Përfituesit e pensionit të të mbijetuarve.	ESSPROS
Përfitues të pensionit në funksionin Papunësia	Përfituesit që marrin përfitime për pensionim të parakohshëm për arsye të tregut të punës.	ESSPROS

5.3 Vështrim i përgjithshëm mbi treguesit e punësimit dhe aftësive për punë

Puna është e rëndësishme për njerëzit jo vetëm si burim të ardhurash, por edhe për të bërë të mundur një përfshirje më të gjerë të tyre në shoqëri. Rëndësia e jashtëzakonshme që ka punësimi për njerëzit është pranuar dhe konfirmuar përmes krijimit të një dimensioni të pavarur të punësimit në Procesin e Përfshirjes Sociale në nivel të BE-së. Tre tregues parësorë dhe dy tregues dytësorë në nivel të BE-së janë ndryshuar me anë të një liste treguesish kombëtarë të punësimit. Anketa e Forcave të Punës (AFP) dhe studimi i INSTAT-it, Burra dhe Gra, bëjnë të mundur mbledhjen e shumicës së të dhënave të kërkuara, por jo ato rreth shkallës së punësimit sipas statusit të veprimtarisë më të shpeshtë gjatë vitit të mëparshëm, intensitetit të punës në familje, përqindjes së personave në punësim informal afatgjatë dhe përqindjes së personave të papunë që kanë hequr dorë nga kërkimi i një pune.

Treguesit e punësimit dhe aftësive

	2. PUNËSIMI DHE AFTËSITË	
Treguesit e BE-së për përjashtimin social	**Përkufizimi**	**Burimi i të dhënave**
- Treguesit parësorë		
1. Shkalla e papunësisë afatgjatë	Përfaqëson përqindjen e personave punëkërkues të papunë për 12 muaj ose më gjatë në popullatën aktive për punë (me moshë 15–64 vjeç).	AeFP
- Treguesit dytësorë		
2. Përqindja e punëkërkuesve të papunëve afatgjatë (në raport me numrin total të të papunëve)	Përqindja e personave punëkërkues të papunë për 12 muaj ose më gjatë, në raport me numrin total të të papunëve.	AeFP
3. Shkalla e papunësisë afatgjatë	Përqindja e personave punëkërkues të papunë për të paktën 24 muaj në popullatën aktive (me moshë 15–64 vjeç).	AeFP
Treguesit kombëtarë		
1. Shkalla e aktivitetit	Përqindja e popullatës së punësuar dhe të papunë (të dyja kategoritë të përkufizuara sipas standardeve të ILO-s), në raport me popullatën në moshë pune (15–64 vjeç). Ky tregues mat ofertën totale të punës në shoqëri gjatë periudhës së vëzhguar. Ajo tregon madhësinë dhe strukturën e burimeve njerëzore në tregun e punës, por nuk tregon përfshirjen në tregun e punës në nivel individual.	AeFP
2. Shkalla e punësimit	Përqindja e personave të punësuar (sipas përkufizimit të ILO-së) në popullatën e moshës për punë (15–64 vjeç). Po kështu, ajo përfaqëson një nga treguesit kyç të tregut të punës që duhet të merret së bashku me tregues të tjerë, ose të ndarë sipas gjinisë, moshës, rajonit, përkatësisë etnike, statusit të punësimit, etj. I marrë në mënyrë të pavarur, ky tregues nuk mund të japë informacion të saktë për punësimin (shkalla e lartë e punësimit në vendet me nivele të larta informaliteti mund të tregojë nivel të lartë angazhimi të popullatës në veprimtari pune informale, shpesh bujqësore dhe joprodhuese, ku ata përfshihen për të mbijetuar në kushtet e një varfërie të skajshme).	AeFP
3. Përqindja e të vetëpunësuarve	Përqindja e personave të punësuar që janë të vetëpunësuar.	AeFP
4. Përqindja e personave që punojnë (pa pagesë) në biznesin familjar	Përqindja e personave që punojnë (pa pagesë) në biznesin familjar.	AeFP
5. Përqindja e të punësuarve që punojnë më pak se 15 orë në javë	Përqindja e personave të punësuar që punojnë më pak se 15 orë gjatë javës së punës, në raport me numrin total të të punësuarve. Tregon papunësinë e fshehur në formën e një niveli jashtëzakonisht të ulët të intensitetit të punës në nivel individual.	AeFP
6. Intensiteti i punës në familje	Përfaqëson raportin e numrit total të muajve që kanë shpenzuar në punë gjatë vitit të mëparshëm anëtarët e familjes në moshë pune ndaj numrit të muajve që mund të kishin shpenzuar këta anëtarë teorikisht në punësim. Tregon intensitet të plotë ose të ulët të përfshirjes së familjes në punë, mund të tregojë edhe dallimet ndërmjet familjeve të disa kategorive të caktuara të	AeFP

	popullatës, si dhe anëtarëve individualë të familjeve, por bën të mundur gjithashtu të kuptohen lidhjet ndërmjet intensitetit të punës dhe aspekteve të varfërisë.	
7 Kujdesi dhe puna e papaguar	Numri mesatar i orëve të shpenzuara në punën e brendshme të papaguar sipas gjinisë.	INSTAT
8. Përqindja e të punësuarve në tregun informal	Përqindja e punëkërkuesve të papunë që punojnë pa kontratë pune, sipërmarrësit dhe të vetëpunësuarit të paregjistruar.	AFP
9. Përqindja e të rinjve jo në punësim, të regjistruar zyrtarisht si të papunë në AKPA, jo në trajnim dhe as duke ndjekur shkollën	Raporti i të rinjve 15–29 vjeç jo në punësim, të regjistruar zyrtarisht si punëkërkues të papunë në AKPA, jo në trajnim dhe as duke ndjekur shkollën (%) - norma NEET.	INSTAT
10. Shkalla e papunësisë së të rinjve	% e të rinjve punëkërkues të papunë në fuqinë punëtore të moshës 15–29 vjeç.	INSTAT
11. Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	% e njerëzve të moshës 15–29 vjeç të papunë për 12 muaj ose më gjatë brenda popullsisë aktive.	INSTAT
12. Raporti i papunësisë së të rinjve	% e të rinjve punëkërkues të papunë në popullatën 15–29 vjeç.	INSTAT
13. Të vetëpunësuar të rinj në shifra absolute	Të vetëpunësuar të rinj 15–29 vjeç, në shifra absolute.	INSTAT
14. Përqindja e të rinjve	Të rinjtë me kontratë të përkohshme, si % e punonjësve të moshës 15–29 vjeç.	INSTAT
15. Struktura sektoriale e punësimit	Përqindja e punësimit në sektorë të veçantë të ekonomisë në raport me punësimin total.[36]	AEFP
16. Shkalla e papunësisë sipas grup-moshës dhe gjinisë	Përqindja e personave që kanë qenë punëkërkues të papunë (sipas përkufizimit të ILO-s) gjatë periudhës referencë, në raport me numrin total të personave aktivë.	AeFP
17. Përqindja e të papunëve që kanë hequr dorë nga kërkimi i punës	Përqindja e personave në varësi që kanë hequr dorë nga kërkimi i punës dhe që kanë kaluar në status joaktiv.[37]	AeFP
18. Përqindja e punëkërkuesve të papunë që janë të regjistruar në Agjencinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (AKPA) /zyrën e punësimit në raport me papunësinë e deklaruar nga INSTAT-i në Anketën e Forcave të Punës.	Përqindja e personave që, sipas përkufizimit të ILO-s, janë punëkërkuesve të papunë ose nuk janë të regjistruar në AKPA, duke përllogaritur shkallën e mbulimit që ka AKPA në regjistrat e saj, në raport me papunësinë që rezulton nga Anketa e Forcave të Punës.[38]	AKPA/INSTAT
19. Përqindja e punëkërkuesve të papunë që janë pjesë e programeve aktive të tregut të punës	Përqindja e punëkërkuesve të papunë të përfshirë në masat e tregut aktiv të punës të AKPA-s, të ndarë sipas programit dhe grupit.	AKPA
20. Shpenzimet buxhetore	Shpenzimet buxhetore të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.	AKPA
21.Përfitues të pagesës së papunësisë	Numri i personave që përfitojnë pagesë papunësie sipas gjinisë dhe grup-moshave	AKPA

[36] Treguesi përshkruan kryesisht strukturën ekonomike të shoqërisë përmes shpërndarjes së forcave të punës, por në të njëjtën kohë tregon edhe nëse disa grupe të caktuara janë privuar nga mundësia e përfshirjes në sektorët zhvillimorë të shoqërisë ose nëse grupe të caktuara përqendrohen në sektorë të caktuar tradicionalë me produktivitet të ulët si dhe në sektorë me kushte pune qartësisht të pafavorshme.

[37] Tregon ndikimet e papunësisë afatgjatë, të papunët "e dekurajuar" që tërhiqen nga tregu i punës për shkak se humbin shpresën se mund të gjejnë një punë.

[38] Tregon përjashtimin nga shërbimet e ndërmjetësimit të institucionit kombëtar përgjegjës për punësimin.

5.4 Vështrim i përgjithshëm mbi treguesit e shëndetit

BE-ja ka vendosur në fokus monitorimin e treguesve të shëndetit, të cilët janë me rëndësi për varfërinë dhe përjashtimin social. Portofoli i treguesve parësorë përfshin dy tregues (jetëgjatësia dhe gjendja shëndetësore e vetëperceptuar sipas nivelit të të ardhurave), pavarësisht kufizimeve të njohura të këtyre treguesve. Për shembull, dallimet në jetëgjatësi mund të vijnë nga zakone të caktuara të ushqyerjes, nga duhanpirja ose nga dallime të tjera në sjellje që jo domosdoshmërish janë të lidhura drejtpërdrejt me përjashtimin social në një vend. Shkalla e vdekshmërisë dhe diferencat në gjendjen shëndetësore nuk janë gjithmonë drejtpërdrejt të ndërlidhura me karakteristikat social-ekonomike.

Rëndësia e treguesve shëndetësorë në vendet e BE-së është në themel të rekomandimeve për politikëbërjen, për të matur në lidhje me treguesit që mund të llogariten.

AANJ përmban një modul specifik për shëndetin, i përbërë nga 3 variabla mbi gjendjen shëndetësore dhe 4 variabla mbi nevojat e papërmbushura për kujdes shëndetësor. Variablat për **gjendjen shëndetësore** përfaqësojnë të ashtuquajturin Moduli Minimal Evropian për Shëndetin[39] dhe matin 3 koncepte të ndryshme të shëndetit: shëndeti i vetëperceptuar; sëmundshmëria kronike (njerëzit me sëmundje ose probleme shëndetësore afatgjata); kufizimi i veprimtarisë – aftësia e kufizuar (kufizime të vetëperceptuara afatgjata në veprimtaritë e zakonshme për shkak të problemeve shëndetësore).

Të gjithë treguesit shprehen si përqindje brenda (ose si pjesë e) popullatës dhe ndarjet bëhen sipas gjinisë, moshës, statusit të punësimit, nivelit arsimor të arritur dhe grupit kuintil të të ardhurave.

Anketa AANJ të BE-së përmban përkufizimet si më poshtë vijon:

Shëndeti i vetëperceptuar përkufizohet përmes pyetjes se si e percepton një person shëndetin e tij/saj në përgjithësi, duke përdorur një nga kategoritë e përgjigjeve: shumë i mirë/ i mirë/ mesatar/ i keq/ shumë i keq.

Sëmundshmëria kronike: ky koncept përkufizohet duke e pyetur të intervistuarin nëse vuan nga ndonjë sëmundje apo problem shëndetësor afatgjatë (me një kohëzgjatje prej të paktën gjashtë muaj).

Kufizimi i veprimtarisë: ky koncept përkufizohet duke përdorur Treguesin Global të Kufizimit të Veprimtarisë (TGKV) për të vëzhguar kufizimet në veprimtaritë e zakonshme të njerëzve si pasojë e një apo disa problemeve shëndetësore. Kufizimi duhet të ketë zgjatur për të paktën gjashtë muajt e fundit. Ka tre kategori të mundshme përgjigjesh: "jashtëzakonisht e kufizuar", "e kufizuar, por jo shumë", ose "aspak e kufizuar".

Nevojat e paplotësuara të vetëraportuara: Vlerësimi i vetë personit nëse ai apo ajo ka pasur nevojë për ekzaminim ose trajtim mjekësor për një lloj të caktuar kujdesi shëndetësor, të cilin nuk e ka përftuar apo nuk e ka kërkuar për arsye financiare ose të tjera.

http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1137&langId=en

Strategjia Evropiane e Punësimit, gjendet në: http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=101

Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe të Punës, gjendet në:

http://www.eurofound.europa.eu/

Fondi Evropian i Përshtatjes me Globalizimin, gjendet në:

http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=326&

Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, gjendet në: http://eige.europa.eu/

Fondi Social Evropian, mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/esf/home.jsp?langId=en

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social, gjendet në:

http://www.eesc.europa.eu/?i=portal.en.home

Rezoluta e Parlamentit Evropian, datë 11 qershor 2013, "Për strehimin social në Bashkimin Evropian" (2012/2293(INI)), gjendet në:

http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&language=EN&reference=P7-TA-2013-246

Platforma Evropiane kundër Varfërisë dhe Përjashtimit Social, gjendet në: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0758:FIN:EN:PDF

Platforma Evropiane kundër Varfërisë dhe Përjashtimit Social, gjendet në: http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=961

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, gjendet në: http://fra.europa.eu/en

Fletorja Zyrtare. (2014) Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe të Planit të Veprimit për Periudhën 2014-2020. Vendimi nr. 635, datë 1.10.2014.

Fondi për Ndihmë Evropiane për më të Deprivuarit, gjendet në:

http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1089&langId=en

Mundësitë e Financimit sipas Politikës së Përbashkët Bujqësore, mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/agriculture/cap-funding/funding-opportunities/index_en.htm

Gerxhani, K. and de Werfhorst, H. G. (2013) " The effect of education on informal sector participation in a post-communist economy" (Ndikimi i arsimit në pjesëmarrjen në sektorin informal në një ekonomi pas-komuniste), Studimi Sociologjik Evropian, 29(3): 464–476

Qeveria shqiptare. (Draft) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020

Guerin, B. (n.d.) Breaking the Cycle of Disadvantage: Early Childhood Interventions and Progression to Higher Education in Europe (Ndërprerja e ciklit të disavantazhit: ndërhyrjet në fëmijërinë e hershme dhe përparimi drejt arsimit të lartë në Europë), Dokument informues nga EPIC, gjendet në: http://europa.eu/epic/studies-reports/docs/rr-553-dg-employment-ecec-brief-v-0-49_final.pdf

ILO (2012) Addressing Social Inclusion through Vocational Education and Training: Updated Information on Social Inclusion in Education and Employment (Trajtimi i përfshirjes sociale nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional: Informacion i përditësuar për përfshirjen sociale në arsim dhe punësim, Tiranë: ILO dhe UNDP

Fondi Monetar Ndërkombëtar. (2014) Shqyrtim i parë sipas marrëveshjes së zgjeruar dhe kërkesës

për modifikimin e kritereve të performancës, gjendet në
http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2014/cr14211.pdf
Investing in Health, Commission Staff Working Document, Social Investment Package, Investimi në shëndetësi; Dokument pune për punonjësit e komisionit; Paketa e Investimeve Sociale, Bruksel, 20.2.2013, gjendet në:
http://ec.europa.eu/health/strategy/docs/swd_investing_in_health.pdf
Janta, B. (n.d.) Caring for Children in Europe: How Childcare, Parental Leave and Flexible Working Arrangements Interact in Europe (Kujdesi për fëmijët në Europë: Si ndërveprojnë kujdesi për fëmijët, leja prindërore, dhe oraret fleksibël të punës në Europë), Dokument informues nga EPIC, gjendet në: http://europa.eu/epic/studies-reports/docs/rr-554-dg-employment-childcare-brief-v-0-16-final.pdf
Kryeministria, Urdhri i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndersektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e Mekanizmit sektorial/ndersektorial të integruar"
Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019–2022
Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2015–2020
Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
Strategjia e Strehimit Social për Republikën e Shqipërisë, 2016–2025
Namati (2014) What do we know about Legal Empowerment? Mapping the Evidence (Çfarë dimë për fuqizimin ligjor? Hartëzimi i provave), gjendet në gjuhën angleze në: http://www.namati.org/publications/what-do-we-know-about-legal-empowerment-mapping-the-evidence/
OECD. (n.d.) Online OECD Employment Database (Baza e të dhënave të punësimit e OECD-së), gjendet në:
http://www.oecd.org/employment/emp/onlineoecdemploymentdatabase.htm
Project Preparation Facility (Instrumenti për Përgatitjen e Projektit). (2014). Governance and Public Financial Management in the Employment, Skills and Social Policy Sector. An Assessment of Structures for Policy and Programme Coordination (Qeverisja dhe menaxhimi i financave publike në punësim, aftësi dhe politika sociale: Një vlerësim i strukturave për bashkërendinimin e politikave dhe të programeve), f. 12
Politika e re për kohezionin social https://ec.europa.eu/regional_policy/2021–2027_en
Ray, D. (1998) Development Economics (Ekonomia e Zhvillimit), Princeton: Princeton University Press
Sen, A. (1999) Development as Freedom (Zhvillimi si Liri), Nju-Jork: Alfred A Knopf
Paketa e investimeve sociale, gjendet në:
http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langIdëen&catId=1044&newsId=1807&furtherNews=yes
Reforma e programit të Ndihmës Ekonomike në Shqipëri
https://www.ilo.org/publications/reform-economic-assistance-programme-albania?lang=sq
Komiteti i Mbrojtjes Sociale, gjendet në: http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=758
Raporti i Komitetit të Mbrojtjes Sociale për Këshillin, Këshilli i BE-së, 6500/10 SOC 115 ECOFIN 101, FSTR 8 EDUC 31 SAN 31, 15 shkurt 2010
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Ndihma ligjore në Shqipëri, Tiranë: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë.
UNDP https://hdr.undp.org/system/files/documents/global-report-document/hdr2021–22reportenglish_0.pdf
UNDP (2013) Praktika dhe politikat për strehimin e romëve në Shqipëri: Studim Analitik, Tiranë: UNDP
UNDP. (2014b) Social Housing in Albania: a Situation Analysis (Strehimi social në Shqipëri: Analizë e situatës), gjendet në:
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/analysis-of-situation-of-social-housing-in-albania/
UNESCO. (n.d.) Education (Arsimi), gjendet në:
http://www.uis.unesco.org/DataCentre/Pages/BrowseEducation.aspx
UN Women. (2011) Harmonized Indicators on Gender Equality and the Status of Women in Albania (Treguesit e harmonizuar për barazinë gjinore dhe statusi i grave në Shqipëri), gjendet në gjuhën angleze në:
http://genderfinancing.unwomen.org/~/media/files/un%20women/grb/resources/harmonised

%20indicators%20on%20gender%20equality%20and%20the%20status%20of%20women%20in%20albania.pdf

White Paper on Social Policy (Dokument Teknik për Politikat Sociale), (COM (94) 333), gjendet në gjuhën angleze në:

http://aei.pitt.edu/1118/1/social_policy_white_paper_COM_94_333_A.pdf

Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2012) Global Health Indicators (Treguesit Globalë të Shëndetësisë)

URDHËR
Nr. 646, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Francës sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë***	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Hauts-de-France	Nord	Avesnes-sur-Helpe*
Hauts-de-France	Nord	Cambrai*
Hauts-de-France	Nord	Dunkerque*
Hauts-de-France	Nord	Douai*
Hauts-de-France	Aisne	Château-Thierry*
Hauts-de-France	Aisne	Vervins*
Hauts-de-France	Aisne	Laon*
Hauts-de-France	Aisne	Soissons*
Grand Est	Moselle	Thionville-Est*
Grand Est	Ardennes	Charleville-Mézières*
Grand Est	Ardennes	Rethel*
Grand Est	Ardennes	Sedan*
Grand Est	Ardennes	Vouziers*
Grand Est	Marne	Vitry-le-François*
Grand Est	Meurthe-et-Moselle	Briey*
Hauts-de-France	Oise	Compiègne*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në

popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 632, datë 16.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Francës", shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 647, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Hessen	Vogelsbergkreis	Alsfeld*
Hamburg	Hamburg	Hamburg*
Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Kalbe (Milde)*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Eiderstedt*
Saarland	Merzig-Wadern	Weiskirchen*
Baden-Württemberg	Rems-Murr-Kreis	Backnang*
Bayern	Aschaffenburg	Hösbach*
Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Wusterwitz*
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Boizenburg/Elbe*
Thüringen	Eichsfeld	Lindenberg/Eichsfeld*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28

dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 631, datë 16.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 648, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybots'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosiïvs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	

Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolavs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Bereznehuvats'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Poltava	Kobeliats'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnytsya	Iampil's'kyi*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 630, datë 16.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 649, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Lazio	Roma*	
Lazio	Rieti*	
Liguria	Genova*	
Liguria	Savona*	
Liguria	La Spezia	Varese Ligure*
Piemonte	Alessandria*	
Piemonte	Novara	Trecate*
Piemonte	Novara	Vinzaglio*
Piemonte	Torino*	
Piemonte	Asti*	
Sardegna	Nuoro*	
Sardegna	Sassari*	
Campania	Salerno	Casaletto Spartano*
Campania	Salerno	Casalbuono*
Campania	Salerno	Buonabitacolo*
Calabria	Reggio Di Calabria*	
Lombardia	Pavia*	
Lombardia	Milano	Besate*
Lombardia	Milano	Vernate*
Emilia-Romagna	Piacenza*	
Emilia-Romagna	Parma*	

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një konteiner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të

paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë

që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 604, datë 5.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 650, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E LETONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ**:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Sakas*
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Kalētu*
Kurzemes	Kuldīgas	Skrundas*
Kurzemes	Kuldīgas	Padures*
Kurzemes	Kuldīgas	Raņķu*
Kurzemes	Kuldīgas	Alsungas*
Kurzemes	Kuldīgas	Īvandes*
Kurzemes	Saldus	Pampāļu*
Kurzemes	Saldus	Zvārdes*
Kurzemes	Talsu	Lībagu*
Kurzemes	Talsu	Dundagas*
Kurzemes	Tukuma	Slampes*
Kurzemes	Tukuma	Vārkavas*
Kurzemes	Tukuma	Smārdes*
Kurzemes	Tukuma	Irlavas*
Kurzemes	Ventspils*	
Latgales	Augšdaugavas	Vecsalienas*
Latgales	Augšdaugavas	Demenes*
Latgales	Augšdaugavas	Maļinovas*
Latgales	Augšdaugavas	Salienas*
Latgales	Augšdaugavas	Bebrenes*
Latgales	Balvu	Lazdulejas*
Latgales	Balvu	Kubulu*
Latgales	Balvu	Lazdukalna*
Latgales	Balvu	Šķilbēnu*
Latgales	Balvu	Balvu*
Latgales	Balvu	Tilžas*
Latgales	Balvu	Rugāju*
Latgales	Balvu	Briežuciema*
Latgales	Briežuciema	Kantinieku*
Latgales	Krāslavas*	
Latgales	Līvānu	Rožupes*
Latgales	Līvānu	Turku*
Latgales	Ludzas*	
Latgales	Preiļu	Rušonas*
Latgales	Preiļu	Riebiņu*
Latgales	Preiļu	Silajāņu*
Latgales	Preiļu	Aizkalnes*
Latgales	Preiļu	Saunas*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Silmalas*
Latgales	Rēzeknes	Ilzeskalna*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Vērēmu*
Latgales	Rēzeknes	Audriņu*
Latgales	Rēzeknes	Bērzgales*
Latgales	Rēzeknes	Nagļu*
Montana	Valchedram*	
Rīgas	Siguldas	Krimuldas*
Rīgas	Siguldas*	
Rīgas	Ropažu*	
Vārmes	Kuldīgas	Vārmes*
Vidzemes	Alūksnes*	
Vidzemes	Cēsu*	
Vidzemes	Gulbenes*	
Vidzemes	Limbažu*	
Vidzemes	Madonas*	
Vidzemes	Smiltenes*	
Vidzemes	Valmieras*	
Vidzemes	Ventspils*	
Vidzemes	Varakļānu*	
Vidzemes	Ogres	Taurupes*
Vidzemes	Valkas	Ērģemes*
Zemgales	Dobeles*	
Zemgales	Jelgavas	Valgundes*
Zemgales	Aizkraukles*	
Zemgales	Jēkabpils*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca

demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë, të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë

përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare, duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 445, datë 13.6.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në shtetin e Letonisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 651, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; neni 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një konteiner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Baden-Württemberg	Emmendingen	Nördlicher Kaiserstuhl
Brandenburg	Barnim	Britz-Chorin-Oderberg
Brandenburg	Dahme-Spreewald	Lieberose/Oberspree wald
Brandenburg	Frankfurt (Oder),	Frankfurt (Oder)
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Lebus
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Bad Freienwalde (Oder)
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Großräschen

Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Ruhland
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Senftenberg
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Altdöbern
Brandenburg	Oder-Spree	Odervorland
Brandenburg	Oder-Spree	Scharmützelsee
Brandenburg	Oder-Spree	Schlaubetal
Brandenburg	Oder-Spree	Eisenhüttenstadt
Brandenburg	Oder-Spree	Brieskow-Finkenheerd
Brandenburg	Oder-Spree	Beeskow
Brandenburg	Oder-Spree	Rietz-Neuendorf
Brandenburg	Spree-Neiße	Schenkendöbern
Brandenburg	Spree-Neiße	Spremberg
Brandenburg	Spree-Neiße	Guben
Brandenburg	Spree-Neiße	Forst (Lausitz)
Brandenburg	Spree-Neiße	Döbern-Land
Brandenburg	Spree-Neiße	Neuhausen/Spree
Brandenburg	Spree-Neiße	Drebkau
Brandenburg	Uckermark	Schwedt/Oder
Brandenburg	Uckermark	Gartz (Oder)
Brandenburg	Uckermark	Oder-Welse
Brandenburg	Uckermark	Angermünde
Brandenburg	Spree-Neiße	Peitz
Brandenburg	Uckermark	Prenzlau
Brandenburg	Dahme-Spreewald	Lübben (Spreewald)
Brandenburg	Cottbus	Cottbus
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Eldenburg Lübz
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Grabow
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Krakow am See
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Pasewalk*
Niedersachse	Emsland	Twist
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel
Sachsen	Bautzen	
Sachsen	Görlitz	Weißwasser/O.L
Sachsen	Görlitz	Diehsa
Sachsen	Görlitz	Bad Muskau
Sachsen	Görlitz	Rietschen
Sachsen	Görlitz	Markersdorf
Sachsen	Görlitz	Boxberg/O.L
Sachsen	Görlitz	Schleife
Sachsen	Görlitz	Niesky
Sachsen	Görlitz	Reichenbach/O.L
Sachsen	Görlitz	Ostritz
Sachsen	Görlitz	Weißer Schöps/Neiße
Sachsen	Meißen	Thiendorf
Sachsen	Meißen	Ebersbach
Sachsen	Meißen	Moritzburg
Sachsen	Meißen	Schönfeld
Sachsen	Meißen	Radeburg
Sachsen	Meißen	Weinböhla
Sachsen	Meißen	Niederau
Sachsen	Nordsachsen	Wermsdorf
Sachsen	Sächsische Schweiz -Osterzgebirge	Lohmen/Stadt Wehlen
Sachsen	Bautzen	Radibor
Sachsen	Bautzen	Königswartha
Sachsen	Bautzen	Neschwitz
Sachsen	Bautzen	Elsterheide*
Sachsen	Bautzen	Spreetal*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Südtondern
Schleswig-Holstein	Kiel	Kiel
Hessen	Groß-Gerau	Biebesheim am Rhein*
Hessen	Groß-Gerau	Stockstadt am Rhein*
Hessen	Groß-Gerau	Riedstadt*
Hessen	Groß-Gerau	Groß-Gerau*
Hessen	Groß-Gerau	Trebur*
Rheinland-Pfalz	Bad Dürkheim	Grünstadt-Land*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një konteiner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Gjermanisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të

përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë

përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 602, datë 5.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 652, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E DANIMARKËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Danimarkës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë***	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Veterinary Inspection Unit South	Tønder*	
Veterinary Inspection Unit South	**Varde***	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore*;*

c) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 629, datë 16.8.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës", shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 654, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3	*Bashki/fshat /provincë
1	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg	
2	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen	
3	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	West-Rügen*	
4	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*	
5	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Oldenburg-Land*	
6	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Bad Bentheim*	
7	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 557, datë 23.7.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 655, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të pa trajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të pa trajtuar termikisht.

Nga shteti i Francës, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Bretagne	Morbihan	Vannes
2	Bretagne	Ille-et-Vilaine	Saint-Malo

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 656, datë 23.8.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Aegean	North Aegean	Lesbos*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Lokroi*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Orestiada*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Alexandroupoli*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë, të cilat nuk janë

të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare, duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjapeve dhe dasheve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

1.3. Urdhri nr. 88, datë 13.2.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

NJOFTIM
Nr. 6827/1, datë 27.8.2024

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, nënshkruar në Tiranë, më 16.10.2024, hyn në fuqi më 21 gusht 2024 për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 27, datë 27.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror"', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhërin nr. 56, datë 23.3.2023, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 'Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH"', ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 27, datë 27.8.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi i të Arratisurve, fashikull nr. 199/9, në ngarkim të B. F., me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

2. Arkivi i Autoritetit, Fondi i të Arratisurve, fashikull nr. 199/7, në ngarkim të B. F., me 245 (dyqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1967–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

3. Arkivi i Autoritetit, Fondi i të Arratisurve, dosje formulare nr. 117, në ngarkim të B. Ç., me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr. 22, bashkëpunimi dhe koordinimi i punës agjentorale operativ ndërmjet organeve të Sigurimit të Shtetit e të Policisë së Kufirit, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

5. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr. 8, studimi bashkëpunimi e bashkërendimi i masave midis organeve të Sigurimit e të Policisë së Kufirit për zbulimin e parandalimin në kohë të veprimtarisë armiqësore të tradhtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

6. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr. 19, përshkrim për shkaqet e arratisjes të dy personave në Jugosllavi, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr. 16, mbi veçoritë e punës së organeve të Sigurimit të Shtetit, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria II, dosja pa numër, fashikuj me procesverbale të thyesve të kufirit, me 254 (dyqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1957. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t'i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 28, datë 27.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror"', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 28, datë 27.8.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Dosar i kuq, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 2 volume, në total me 844 (tetëqind e dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

2. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, Dosje pune dhe personale nr. 1265, "Bleta", në ngarkim të K. F., me 436 (katërqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

3. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, Dosje formulare nr. 3397, në ngarkim të Z. H., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Dosar i verdhë, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 804 (tetëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

5. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit A. I., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

6. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit K. E., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Kosova, Dosja nr. 4475, në ngarkim të M. H., me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1945–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, Dosje formulare nr. 480, në ngarkim të T. T., me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1951–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t'i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Gentiana Sula

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/09/02 13:55:29 +02'00'
2bce84f1632548 53a85625f879704faf2024090213 551683031

Çmimi 353 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)